



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 42 (827794)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 21 tetor 2022

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Takimin 2-ditor të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi mori pjesë në Takimin 2-ditor të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s, që u mbajt në selinë e NATO-s, në Bruksel. Në fokus të diskutimeve të ministrave të Mbrojtjes ishte rritja e kontributit për Ukrainën dhe forcimi i mbrojtjes së NATO-s, në situatën e krijuar nga agresioni rus në Ukrainë. Ministri Peleshi e vlerësoi mjaft të rëndësishëm këtë takim që, siç tha ai, vjen në një moment tepër

kritik për mbrojtjen dhe sigurinë e aleatëve dhe adresimin e ndihmës së vazhdueshme për Ukrainën. Ministri i Mbrojtjes falënderoi Aleancën dhe vendet partnere për gatishmërinë e treguar për të ndihmuar Shqipërinë pas sulmeve kibernetike të muajve të fundit. Ai i siguroi vendet aleate se Shqipëria po bën përpjekje të vazhdueshme për ngritjen dhe forcimin e masave mbrojtëse ndaj infrastrukturës kritike

dhe sigurisë kibernetike, në bashkëpunim edhe me vende e struktura të specializuara në këtë fushë. Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve, Lloyd Austin në fjalën e tij dënoi me forcë sulmin kibernetik ndaj shërbimeve online në vendin tonë dhe bëri thirrje për rritjen e vigjilencës dhe kapaciteteve mbrojtëse të vendeve të Aleancës dhe vendeve partnere në këtë fushë. Në këtë Ministerial Shqipëria theksoi mbështetjen e saj... >> faqe 2



Nis viti i ri akademik në AFA

Ministri Peleshi: Synojmë që të përgatisim këtu ekselencën karakteriale dhe dijes shqiptare



>> faqe 3

Gjeneral brigade Bilbil Bitri merr detyrën e komandantit të AFA-së

Gjatë ceremonisë së fillimit të vitit të ri akademik, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi prezantoi komandantin e ri të Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri. Në ceremoninë e organizuar ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, studentë, kursantë si dhe stafi pedagogjik i AFA-së. Mes të tjerash ministri Peleshi tha: "Këtë vit akademik, i cili përkon edhe me emërimin e komandantit të ri të Akademisë së Forcave të Armatosura..."



>> Faqe 3

Forcat Speciale kremtojnë 24-vjetorin e krijimit

Batalioni i Forcave Speciale (bFS), kremtoi 24-vjetorin e krijimit të tij. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në ambientet e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore (FT), merrnin pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Arben Zani, anëtarë të komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare, komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale nënkolonel Ajet Jata, komandantë të reparteve vartëse të FT-së...



>> Faqe 4

Et'hem Ibrahim, "skënderbegasi" elitar i ringut

Et'hem Ibrahim u lind më 4 maj të vitit 1942, në qytetin e Vlorës. Et'hemi është rritur dhe edukuar në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" dhe më pas në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë. Në vitin 1963 ai titullohet oficer aktiv dhe emërohet në detyrë në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej". Më vonë ka kryer detyra të ndryshme edhe në reparte të tjera, në shtabet dhe njësitë e garnizonit të Tiranës. Në vitin 1983 emërohet me detyrë në Ministrinë e Mbrojtjes, me gradën "Nënkolonel", derisa del në rezervë në...



>> Faqe 6

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi mori pjesë në Takimin 2-ditor të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s, që u mbajt në selinë e NATO-s, në Bruksel.

Në fokus të diskutimeve të ministrave të Mbrojtjes ishte rritja e kontributit për Ukrainën dhe forcimi i mbrojtjes së NATO-s, në situatën e krijuar nga agresioni rus në Ukrainë.

Ministri Peleshi e vlerësoi mjaft të rëndësishëm këtë takim që, siç tha ai, vjen në një moment tepër kritik për mbrojtjen dhe sigurinë e aleatëve dhe adresimin e ndihmës së vazhdueshme për Ukrainën.

Ministri i Mbrojtjes falënderoi Aleancën dhe vendet partnere për gatishmërinë e treguar për të ndihmuar Shqipërinë pas sulmeve kibernetike të muajve të fundit. Ai i siguroi vendet aleate se Shqipëria po bën përpjekje të vazhdueshme për ngritjen dhe forcimin e masave mbrojtëse ndaj infrastrukturës kritike dhe sigurisë kibernetike, në bashkëpunim edhe me vende e struktura të specializuara në këtë fushë.

Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve, Lloyd Austin në fjalën e tij dënoi me forcë sulmin kibernetik ndaj shërbimeve online në vendin tonë dhe bëri thirrje për rritjen e vigjilencës dhe kapaciteteve mbrojtëse të vendeve të Aleancës dhe vendeve partnere në këtë fushë.

Në këtë Ministerial Shqipëria theksoi mbështetjen e saj për projektin e Porto Romanos, si një nyje e rëndësishme detare edhe në funksion të NATO-s.

Ndërkaq, ministri Peleshi theksoi gjatë fjalës së tij edhe rëndësinë që Aleanca i jep rajonit të Ballkanit, duke shtuar se kjo vëmendje duhet të jetë më e shtuar edhe në aspekte të tjera diplomatike dhe ekonomike, në interes të integritimit të rajonit edhe në organizma të ndryshme politike,



MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI MORI PJESE NË TAKIMIN 2-DITOR TË MINISTRAVE TË MBROJTJES TË VENDEVE TË NATO-S

Peleshi: Shqipëria, përpjekje për ngritjen dhe forcimin e masave mbrojtëse ndaj infrastrukturës kritike dhe sigurisë kibernetike

Sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve, Lloyd Austin në fjalën e tij dënoi me forcë sulmin kibernetik ndaj shërbimeve online në vendin tonë.

ekonomike dhe ushtarake.

Gjatë punimeve të këtij takimi, ministri Peleshi zhvilloi takime të ndryshme me homologët të vendeve të tjera, ku u diskutua për çështje në interes të rritjes dhe bashkëpunimit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.



Struktura e më e re e krijuar, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS) nisi vitin e ri akademik për tre kurset institucionale të karrierës ushtarake të oficerëve të FA-së, në të cilat mirëpresim dhe 23 kursantë nga radhët e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Jemi të vendosur të çojmë para përmirësimin e përgatitjes arsimore, programeve, modernizimin e metodologjisë dhe koncepteve të mësimdhënies, për të rritur nivelin e formimit të lidershipit ushtarak.



Nis viti i ri akademik në AFA

Ministri Peleshi: Synojmë që të përgatisim këtu ekselencën karakteriale dhe dijes shqiptare

Nisi viti i ri akademik edhe për studentët dhe kursantët e Akademisë së Forcave të Armatosura. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e cilësoi Akademinë e FA-së si një nga projektet prioritare të Ministrisë së Mbrojtjes, që po avancojnë në bashkëpunim edhe me partnerin strategjik, SHBA-në. Ministri Peleshi uroi studentët dhe stafin pedagogjik për një vit të mbarë, ndërsa bëri me dije, për studentët e rinj, investimin që ky institucion, me mbështetjen e qeverisë shqiptare, po kryhen në mbështetje të Akademisë së FA-së.

“Po punojmë për ndërtimin e kampusit të ri të AFA-së me të gjithë parametrat. Është duke përfunduar master-plani, aty ku sot është Batalioni i Mbështetjes, kemi në përfundim procedurat për lidhjen e kontratës dhe fillimin e ndërtimit të godinës së parë. Jam i bindur që në rajon do të jetë projekti më i mirë, më i bukur dhe më i plotë”, - u shpreh ministri Peleshi.

Në situatën e re të sigurisë, sipas z. Peleshi, sfida është edhe ngritja e nivelit të kërkimit shkencor.

“Ne duam ta bëjmë AFA-në realisht avangardë të mendimit shkencor, të dijes, të karakterit. Synojmë që të përgatisim këtu ekselencën karakteriale, por edhe të dijes shqiptare, të japim shembujt dhe modelin më të mirë të patriotëve të vërtetë me vepra dhe jo me fjalë. Ne po ndërtojmë qendrën e Inovacionit, e cila po merr jetë dhe shumë shpejt do të jetë funksionale”, - deklaroi ministri i Mbrojtjes.

Sipas ministrit Peleshi, teknologjia duhet të jetë fjala kyçe e ristrukturimit të Akademisë së FA-së, duke përmendur këtu faktin se për pak muaj Shqipëria do të ketë një flotë dronësh të teknologjisë së fundit për botën

ushtarake, por edhe civile, të cilët do të përdoren si burim informacioni për shërbime të ndryshme të institucioneve të vendit.

Ministri Peleshi tha se brenda FA-së, prej 1 viti ka filluar programi i Masterit të Sigurisë Kibernetike, një disiplinë që është bërë e së tashmes, për shkak edhe sulmit kibernetik, nga i cili u prek vendi ynë. “Duhet t’i kontribuojmë sistemit të sigurisë kibernetike, si pjesë e sigurisë kombëtare, edhe ne si institucion i edukimit ushtarak, duke prodhuar ekspertë, specialistë të kësaj fushe. Kemi shpallur 7 vende pune për specialistë të sigurisë kibernetike dhe më vjen mirë që ka shumë interes”, - bëri të ditur ministri Peleshi, duke shtuar se qeveria ka miratuar paga speciale për këtë sektor.



Gjeneral brigade Bilbil Bitri merr detyrën e komandantit të AFA-së

Gjatë ceremonisë së fillimit të vitit të ri akademik, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi prezantoi komandantin e ri të Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri. Në ceremoninë e organizuar ishte i pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, studentë, kursantë si dhe stafi pedagogjik i AFA-së.

Mes të tjerash ministri Peleshi tha: “Këtë vit akademik, i cili përkon edhe me emërimin e komandantit të ri të Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, AFA në auditorët e saj, mirëpret 212 studentë.

Gjeneral brigade Bitri ka një karrierë të gjatë në Forcat e Armatosura dhe ka kryer me profesionalizëm të gjitha detyrat që ka mbajtur, dhe jam shpresëplotë që edhe në këtë detyrë, ai do çojë përpara të gjithë objektivat në drejtim të rritjes së cilësisë së arsimimit dhe stërvitjes, përgatitjes së kurrikulave me objektiva, synime dhe programe bashkëkohore”.



“Për më se tre vjet, studentët e programit “Bachelor” dhe gjatë një viti, Kursi i Përgatitjes së Oficerit të ri, do të aftësoheni, përgatitni dhe formoheni për të drejtuar dhe komanduar. Krahas formimit bazë si oficerë, ju do të keni shansin që të arsimoheni dhe diplomoheni edhe në degë të dyta si në Shkenca Ushtarake, Teknologji Informacioni dhe Navigim Detar.”



Akademia e Forcave të Armatosura vitin e ardhshëm do të ndryshojë kohëzgjatjen e studimeve “Bachelor” nga tre vjet në katër vjet, duke pasuruar gjithashtu edhe larinë e degëve që do të ofrojë. Krahas programeve të studimit në degët Teknologji Informacioni, Navigim Detar dhe Shkenca Ushtarake, do të hapen dhe dy programe të reja studimi në: Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe në Shkenca

Komunikimi.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji në fjalën e tij përshëndetëse me rastin e fillimit të vitit të ri akademik dhe marrjes së detyrës së komandantit të AFA-së nga gjeneral brigade Bitri, do t’i shprehte përgëzimet e tij për marrjen e detyrës, gjeneral brigade Bitrit, si një ushtarak me përvojë të gjatë pune në sektorë të ndryshëm të Forcave të Armatosura, ku çdo detyrë i është përgjigjur me devotshmëri dhe përkushtim të lartë.

Me tej gjeneral brigade Kingji do shprehej se: “Puna jonë do të orientohet në rritjen e cilësisë së sistemit të edukimit dhe të arsimimit të oficerëve të së ardhmes të FARSH, përmes një vizioni të ri sa më bashkëkohor dhe profesionist.

Ndërsa në fjalën e tij, gjeneral brigade Bitri do të shprehte mirënjohjen për vlerësimin e dhënë dhe përkushtimin për ecurinë me produktivitet të lartë të AFA-së si institucioni më i lartë i arsimimit ushtarak.

Forcat Speciale kremtojnë 24-vjetorin e krijimit



Batalioni i Forcave Speciale (bFS), kremtoi 24-vjetorin e krijimit të tij. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në ambientet e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore (FT), merrnin pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Arben Zani, anëtarë të komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare, komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale nënkolonel Ajet Jata, komandantë të reparteve vartëse të FT-së, si dhe përfaqësues nga shtabi i FT-së.

Ceremoninë e hapi komandanti i ROS-së, nënkolonel Jata, i cili në fillim bëri një rezymë të krijimit të batalionit të Forcave Speciale ndër vite dhe të angazhimeve të tyre si brenda ashtu edhe jashtë kufijve shtetërorë, në interes të paqes dhe sigurisë në vend, në rajon por edhe me gjerë. Më tej, në fjalën e tij, nënkolonel Jata nuk harroi të përmendë edhe sakrificën e këtij efektivit, ku në majë të saj qëndron gjaku i derdhur nga Dëshmori i Atdheut kapiten Feti Vogli.

Por sipas komandantit të ROS-së, arritjet profesionale të bFS-së nuk do të ishin në këtë nivel pa ndihmën e aleatëve tanë në NATO, ku padyshim roli SHBA-së, Turqisë dhe Britanisë së Madhe ngelet më i spikatur.

Më pas, duke marrë fjalën



zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral Ferdinand Dimo, vlerësoi punën e mirë të bërë në vite nga efektivët e këtij reparti elitë, duke veçuar kontributin e tyre në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, por duke mos lënë mënjanë edhe rolin e padiskutueshëm të forcave speciale në ndihmë të komunitetit, sidomos në rastet e fatkeqësive natyrore.

“Misioni juaj është i veçantë dhe realizimi i këtij misioni, kërkon po ashtu ushtarakë më aftësi të veçanta. Gjatë gjithë historisë tuaj, që nga dita e parë e krijimit dhe deri më sot, ju keni treguar se profesionalizmi, disiplina dhe përkushtimi në realizimin



e detyrave, nuk ju kanë munguar kurrë. Jam i bindur që edhe në të ardhmen, reparti juaj do të vijojë të përmbushë më të njëjtin përkushtim të gjitha detyrat, duke kaluar me sukses çdo sfidë që koha do paraqesë para jush..”- u shpreh ndër të tjera gjeneral Dimo.

Në emër të komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare, aktiviteti u përshëndet gjithashtu edhe nga deputeti dhe anëtar i këtij komisioni z. Bardhyl Kollçaku, i cili duke uruar forcat speciale për përvjetorin e krijimit të tyre, theksoi rëndësinë e veçantë që kanë këto forca në realizimin e misionit kushtetues të Forcave të Armatosura, në përgjithësi. Ai shprehu falënderimet e tij për punën mjaft të mirë që efektivët e këtij reparti kanë bërë ndër vite dhe i siguroi ata për mbështetjen e vijueshme, jo vetëm të komisionit të Sigurisë Kombëtare, por edhe të Parlamentit shqiptar në tërësi.

Batalioni i Forcave Speciale, u krijua në vitin 1998 si nevojë e kohës në përgjigje të sfidave dhe situatave gjeopolitike. Prej 24 vitesh tashmë, ky reparti elitë vijon traditën e tij të ruajtjes së një profesionalizmi, disipline, përkushtimi dhe standardi shumë të lartë, në realizimin e çdo detyre të ngarkuar si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Për kryerjen me devotshmëri dhe profesionalizëm të misionit të tij, ky reparti është dekoruar disa herë nga autoritetet më të larta shtetërore.

Marshimi në një distancë prej 18 kilometrash në terren malor, me pajime dhe situata taktike, iu shërbeu rekrutëve të kursit të Stërvitjes Individuale Bazë (SIB), në batalionin e Tretë të Këmbësorisë (b3K), për rritjen e kondicionit fizik dhe aftësi profesionale individuale.



Rikonicioni dhe vëzhgimi, i sigurojnë komandantit informacionin e nevojshëm për përmbushjen e misionit. Efektivët e batalionit të Tretë të Këmbësorisë (b3k), përsosin çdo ditë aftësitë e tyre operacionale në këtë drejtim.



Nis nga Fieri procesi i vlerësimit të riskut në nivel qendror

Ka nisur nga qarku i Fierit procesi i vlerësimit të riskut në nivel vendor. Në prani të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Mbrojtjes Civile (AKMC), Haki Çako, prefektit të Fierit Lefter Shehaj si dhe përfaqësuesve të UNDP-së dhe Ambasadës Suedeze në Tiranë, u zhvillua takimi i parë i grupit ndërinstucional teknik të punës me institucionet përgjegjëse për Mbrojtjen Civile për gjashtë bashkitë e Prefekturës Fier, përkatësisht bashkinë Fier, Lushnje, Divjakë, Patos, Roskovec dhe Mallakastër.

“Fillimi i punës për dokumentin e vlerësimit të riskut në nivel vendor në gjashtë bashkitë e Prefekturës Fier do të plotësojë kuadrin ligjor në harmoni me dokumentin e Vlerësimit të Riskut në nivel qendror, që pritet të miratohet shumë shpejt”, - tha drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së, z. Haki Çako.

Dokumenti i vlerësimit të riskut për 6 bashkitë e Prefekturës Fier është pikënisja për menaxhimin efikas të riskut të fatkeqësive në nivel vendor”, - u shpreh përfaqësuesi rezident ad interim i UNDP-së në Shqipëri Nuno Queiros.

Zhvillimi i këtij dokumenti pason Dokumentin Kombëtar të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive dhe Strategjinë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive dhe Planin e Veprimit, që janë realizuar me ekspertizën vendase dhe të huaj të projektit RE-SEAL, të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.



Një ekip ekspertësh do të asistojë institucionet vendore në hartimin e këtyre dokumenteve të rëndësishëm, të cilët do të shërbejnë për të orientuar punën e strukturave vendore për mbrojtjen dhe parandalimin nga fatkeqësitë si dhe në vijim për përgatitjen e Strategjive lokale të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive dhe Planeve lokale të Mbrojtjes Civile.



Ky takim u parapri nga një bashkëbisedim dhe një ekspozitë me punime të nxënësve të shkollave 9 - vjeçare të Prefekturës Fier, realizuar në bash-

këpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parashkollor Fier, me tematikë “Nga paralajmërimi i hershëm në veprimin e hershëm” në kuadër të

Ditës Ndërkombëtare të Reduktimit të Rrezikut të Fatkeqësive dhe rëndësinë që gjithsecili ka në reduktimin e impaktit dhe përgatitjen në rast fatkeqësie.

Anija italiane “Amerigo Vespucci” realizoi një vizitë në Portin e Durrësit

Anija - shkollë e Forcave Detare italiane “Amerigo Vespucci” e konsideruar si një ndër anijet më të bukura në botë, me ftesë të komandantit të Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, zhvilloi një vizitë portuale në portin e Durrësit.

Anija me vela “Amerigo Vespucci” ka filluar të lundrojë qysh prej vitit 1931 dhe është anija simbol e Forcës Detare Italiane. Në këtë anije janë edukuar dhe trajnuar breza të tërë oficerësh, ndër të cilët edhe shumë kadetë shqiptarë që kanë ndjekur studimet në Akademinë Detare të Livornos.

Gjatë kohës së qëndrimit të anijes në vendit tonë, janë zhvilluar vizita dhe takime zyrtare në anije nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji si dhe një vizitë e komandantit të anijes “Amerigo Vespucci”, kapiten i rangut I Luigi Romagnoli, në Komandën e Forcës Detare, ku u prit nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra.

Po ashtu, për efektivin e anijes u



organizuan vizita në Muzeun e Krujës si dhe një ndeshje futboll midis efektivit të anijes dhe efektivëve të Forcës Detare.

Gjithashtu, anija ka qenë e hapur për t'u

vizituar nga qytetarët e Durrësit, Tiranës dhe rrethinave përreth. Gjatë tre ditëve anija është vizituar nga më tepër se 12 000 qytetarë.



ET'HEM IBRAHIMI, "skënderbegasi" elitar i ringut

*Një jetë të tërë mes uniformës ushtarake dhe dorezave të boksit,
Et'hemi Ibrahim, njeriu model i dalë nga "Fidanishtja e Skënderbegasve"*

INTERVISTOI:
ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Et'hemi Ibrahim u lind më 4 maj të vitit 1942, në qytetin e Vlorës. Et'hemi është rritur dhe edukuar në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" dhe më pas në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë.

Në vitin 1963 ai titullohet oficer aktiv dhe emërohet në detyrë në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej".

Më vonë ka kryer detyra të ndryshme edhe në reparte të tjera, në shtabet dhe njësitë e garnizonit të Tiranës. Në vitin 1983 emërohet me detyrë në Ministrinë e Mbrojtjes, me gradën "Nënkolonel", derisa del në rezervë në vitin 1992, në kuadër të reformës. Gjatë gjithë kohës që shërbeu në ushtri, njohu vështirësitë, lodhjen, sakrificën dhe gëzimin.

Brenda uniformës rrinte një shpirt fisnik dhe i ndjeshëm ndaj lirisë e hoveve, por dhe i meditimeve për jetën, për familjen, për shoqërinë në tërësi, për botën shpirtërore. Et'hemi, që herët është angazhuar me sportin e boksit me ekipet zinxhir të "Partizanit" me trajner të madhin Ali Kastrati, "Babai" i sporteve të rënda në Shqipëri. Në personalitetin e tij, gjithë jetës ka mbartur e mbart virtytet më të mira të njeriut, ai është bashkëshort shembullor, baba dhe gjysh i ndjeshëm. Pas daljes në pension, Et'hemi bëhet promotor i organizimit dhe funksionimit të grupit nismëtar të fillimit të boksit në Shqipëri, pas ndryshimeve politike të vitit 1990. Gjatë periudhës 1991-2008, ka ushtruar disa funksione në Federatën Shqiptare të Boksit.

Et'hemi Ibrahim është autor i tre librave voluminoz "Historia e boksit Shqiptar", që në një farë mënyre, janë historik i këtij sporti në vendin tonë.

Për sukseset e arritura në punë e në sport, Et'hemit i janë akorduar disa medalje nga Kuvendi i Shqipërisë. Është anëtar nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ. Mban gjithashtu titullin "Mjeshtër Sporti" dhe medalje "Mirënjohjeje" nga Federata Shqiptare e Boksit.

Për këtë rrugëtim të gjatë, të vështirë, por të bukur si ushtarak karriere dhe elitë e sportit të boksit, z. Et'hemi vjen për lexuesin në një rrëfim të sinqertë, ashtu siç miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij e njohin.

Si nisi rrugëtimi juaj drejt uniformës ushtarake?

Në vitin 1957, unë së bashku me disa moshatarë të tjerë u nisëm drejt shkollës ushtarake "Skënderbej", me qëllimin e madh për t'u bërë një kuadër i ushtrisë dhe për t'i shërbyer me devotshmëri atdheut, ashtu siç dhe ishim edukuar në familjet tona.

Gjatë studimeve në shkollën e Bashkuar, në u përgatitëm si oficerë.

Shkolla "Skënderbej" është vatra ku ne u rritëm, edukuam dhe u bëmë të aftë e të përgjegjshëm për të qenë të devotshëm në të gjitha detyrat që na ngarkoheshin, në shërbim të atdheut e të shoqërisë...

Kjo shkollë, unikalë në llojin e vet, na kaliti durimin, guximin, aftësitë profesionale, intelektuale, por dhe durimin për të dhënë gjithçka në të mirë të detyrës. Unë kam kujtime të shumta nga kjo shkollë e dashur, fillimisht si skënderbegas, si sportist dhe si edukator-komandues për shumë



vite për breza skënderbegasish.

Cilat ishin fillesat tuaja drejt sportit të boksit?

Fillimi im me sportin e bukur të boksit, të cilit iu përkushtova një jetë, nisi në vitin 1957-1958 dhe lidhet me mjeshttrin Ismet Bellova.

Ishte Ismet Bellova që spikati tek unë talentin, duke investuar që unë e shokët e mi, të përgatiteshim e të bëheshim sportistë cilësorë. Ai na 'zbuloi', duke na dorëzuar mua, Rami Sadushin, Kristaq Laçin, Lutfi Hasanin e Ismet Varfin tek trajneri i njohur i "Partizanit", mjeshtri Ali Kastrati.

Kur filluat të shkëlqenit ringun e parë si boksier?

Si boksier, nisa ballafaqimet në kampionatin lokal të kryeqytetit (viti 1958-1959), kampio-

natin kombëtar të të rinjve në Shkodër (muaj maj 1959), në Spartakiadat e Ushtrisë, ku ne, 16-17 vjeçar, duhet të ndesheshim me 20 vjeçar e më lart, duke dalë të fituar pothuaj në gjithë ballafaqimet. Kam fituar shumë tituj kampioni, si boksier me "Partizanin", duke qenë sportisti boksier skënderbegas që kam fituar 6 tituj të tillë, më shumë se çdo boksier skënderbegas.

A keni pasur përballje në takime ndërkombëtare?

Kam pasur takime dhe fitore ndërkombëtare, ku veçoj ato me koreanët në Tiranë... Jam nga nismëtarët bashkë me Kristaq Laçin, Ismet Varfin, Lutfi Hasanin, Pavli Dudin, profesor Ismet Bellovën e të madhin Ali Kastratin etj., (pothuaj të gjithë skënderbegas) në rikrijimin e Shoqatës dhe më pas të Federatës Shqiptare të Boksit, pas vitit 1990. Njëkohësisht, unë kam kujtime



ET'HEMI, QË HERËT ËSHTË ANGAZHUAR ME SPORTIN E BOKSIT ME EKIPET ZINXHIR TË "PARTIZANIT" ME TRAJNER TË MADHIN ALI KASTRATI, "BABAI" I SPORTEVE TË RËNDA NË SHQIPËRI. NË PERSONALITETIN E TIJ, GJITHË JETËS KA MBARTUR E MBART VIRTYTET MË TË MIRA TË NJERIUT, AI ËSHTË BASHKËSHORT SHEMBULLOR, BABA DHE GJYSH I NDJESHËM. PAS DALJES NË PENSION, ET'HEMI BËHET PROMOTOR I ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË GRUPIT NISMËTAR TË FILLIMIT TË BOKSIT NË SHQIPËRI, PAS NDRYSHIMEVE POLITIKE TË VITIT 1990. GJATË PERIUdhës 1991-2008, KA USHTRUAR DISA FUNKSIONE NË FEDERATËN SHQIPTARE TË BOKSIT.

të paharruara gjatë kohës që shërbeva si komandues e mësimdhënës në Shkollën Ushtarake "Skënderbej". Ishte kënaqësi të jepje mësim me skënderbegasit (kryesisht jepja përgatitjen ushtarake e histori) inteligjentë, të disiplinuar, të etur për dije e që dinin të respektonin. Kisha shumë kolegë e bashkëpunëtorë model, që me mësimdhënien cilësore kishin fituar respektin e brezave të skënderbegasve... Do të përmend këtu Viron Cinxon, Gjylizare Çiçon, Ismet Bellovën, Bejkush Birçen, deri tek drejtori i palodhur Fiqri Shtëpani.

Dhe sot, që jam në pension, ndjej kënaqësi kur më takojnë në rrugë skënderbagasit, nxënësit e mi, sot të rritur e në funksione të rëndësishme, të cilët më flasin, respektojnë dhe falënderojnë.

Jam anëtar i kryesisë së shoqatës "Skënderbegasi", e përiqem të kontribuoj sa mundem në të mirë të emrit të kësaj shkolle të lavdishme!

Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura, simbolika e shtetit shqiptar

Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura është trupa artistike profesioniste e FA-së, e përbërë nga kontingjente të përzgjedhura muzikantësh të talentuar.

Si formacion muzikor, ajo u krijua më 18 tetor 1944, në fshatin Priskë të Tiranës, ku me urdhër të Shtabit të Korparmats së Parë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, u grumbullua një grup i madh muzikantësh partizanë dhe u formua orkestra frymore e këtij formacioni të madh partizan. Pas Çlirimit, kjo orkestër u plotësua me të gjithë elementet e nevojshme të një bande muzikore moderne.

Në fillim ajo u quajt Orkestra Frymore e Ushtrisë Kombëtare dhe më vonë Orkestra frymore e Ushtrisë Popullore.

Ajo është pjesë e rëndësishme e ceremonive zyrtare të shtetit shqiptar, që i jep tonin solemn momenteve të zbatimit të protokollit shtetëror. Që nga krijimi i saj e deri më sot, ajo ka një histori shumë të pasur aktivitetesh të rëndësishme që përbëjnë edhe pjesën më të qenësishme të krenarisë së saj legjitime. Aktivitetet artistike të realizuara prej saj janë shtuar, veçanërisht pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, pjesë e së cilës janë edhe Forcat e Armatosura shqiptare, pas vitit 2008.

Pararendëse e Bandës Muzikore "Vatra", që frymëzoi vullnetarët shqiptaro-amerikanë, pjesëmarrës në Luftën e Vlorës 1920

Zanafilla e këtij formacioni kompleks muzikor, në fakt qëndron në vetë shpirtin luftarak të Kombit shqiptar, në historinë e tij të luftërave shekullore kundër pushtuesit të huaj. Rituale të kahershme kur binin trimat në luftë, apo kur ata varroseshin me të gjitha nderet që iu takonin, më pas shoqëroheshin nga këngët e trimërisë, që brenda tyre kishin tinguj që të bëjnë të ndjehesh krenar. Kështu, një moment i rëndësishëm që evidenton qëllimin dhe misionin e madh që ka pasur Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura në historinë pararendëse të saj, ka qenë viti 1920, dhe pikërisht Lufta e Vlorës. Me këngët e saj, Banda Muzikore "Vatra" mbajti lart moralin e forcave që luftonin furishëm në Tepele-në, Drashovicë dhe kudo përreth qytetit të Vlorës. Kjo luftë e pashembullt, ku luftonte një popull i vogël dhe i paarmatosur me një fuqi të madhe, kishte marrë përmasat e një beteje epike. Dhe po epike u bë edhe kënga "Vlora-Vlora", simboli i kësaj lufte: "Vlora, Vlora, Vlora, Vlora, / Rroki armët, bëja fora! / Vlora, Vlora, Vlora, Vlora, / Bjeri më të lumtë dora!". Dhe siç dihet, kjo këngë



Banda Kombëtare "Vatra" e krijuar në Worcester, Mass. USA

simbol, e kënduar nga Banda "Vatra" shoqëroi Komitetin "Mbrojtja Kombëtare" dhe luftëtarët popullorë, më 3 shtator 1920, në manifestimet e fitores së Luftës së Vlorës.

Në vitin 2020, u bë dekorimi i kësaj Orkestre në 100-vjetorin e Luftës së Vlorës, nga institucionin i Presidentit të Republikës, me titullin e lartë "Kalorësi i Urdhrit të Flamurit".

Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura mbart simbolikën e shtetit shqiptar dhe të institucioneve të lidhura ngushtësisht me të. Kjo bandë është e djeshmja dhe e sotmja e një tradite të bukur muzikore shqiptaro-amerikane, sepse zanafillën e ka në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me krijimin e Bandës Kombëtare "Vatra" nga Thoma Nasi, trashëgimia e të cilës vijon sot, pas 78 vitesh, me Orkestrën Frymore të Forcave të Armatosura. Ky vlerësim është nderim për të gjithë anëtarët e saj dhe drejtuesin Thoma Nasi, të cilët lanë Amerikën

për të ndihmuar Atdheun, që deshën mbi gjithçka lirinë për vendin e tyre dhe që e shprehën këtë dashuri me muzikën e tyre.

Edhe pse gjatë pushtimit nazist, gjermanët i ndaluan veprimtaritë e saj, dhe në vitin 1943 banda zyrtare shqiptare u shpërnda.

Riorganizimi, dhe lançimi i formacioneve korale e muzikore dhe i institucioneve të reja madhore e bashkëkohore gjatë viteve 1950 - 1990 e në vazhdim patën zhvillim dhe prurje te reja.

Thoma Nasi, shqiptari, patrioti dhe muzikanti i thekur shumëplanësh.

Roli i tij vlerësohet si përcaktues, sublim në shumë aspekte të Historisë së Muzikës Shqiptare, por edhe të angazhimit të tij të drejtpërdrejtë patriotik në marrëdhënie me konceptin e tij largpamës, se si ndikon edukimi emancipues kulturor e artistik në zhvillimin e ndërgjegjes dhe frymëzimit kombëtar. Për këtë, në libër aludohet paravolia se ndikimi i veprimit muzikor të Nassit tek entiteti shqiptar mund të krahasohet me rolin dhe influencën që patën kompozitorë të famshëm të tillë si Beethoven, Mozart, Verdi, Liszt, Çajkovski, Shtraus, Puçini, Stravinski, Dvorak, Sibelius, etj., në rritjen dhe forcimin e identitetit dhe krenarisë së kombeve të tyre. Me të drejtë, sepse edhe përfshirja e Thoma Nassit në arenën kombëtare të zhvillimeve muzikore shqiptare, sidomos në fushat e kompozimit të këngëve patriotike e himneve, këngëve qytetare e lirike

me rrënjë të forta në traditën muzikore qytetare e popullore shqiptare, si dhe sjelljes ndaj muzikës simfonike, por duke e ridimensionuar atë; apo aftësia dhe pasioni i tij për të organizuar shoqëri kulturore artistike, banda, formacione të tjera muzikore e kulturore patën në të gjithë kombin

shqiptar tërheqjen magnetike të një fuqie të shpejtë e të gjerë në çdo skaj të vendit e popullit tonë.

Thoma Nasi, njihet si muzikanti i parë shqiptar i shkolluar në SHBA, gjithashtu si teoricieni, studiuesi, vlerësuesi e parashikuesi i zhvillimeve të muzikës bashkëkohore shqiptare, si botuesi i disa prej perlave të këngëve e muzikës shqiptare të gjysmës së parë të shek. XX, si edukatori dhe pedagogu i disa brezave e shkollave muzikore dhe evidentuesi i artistëve të talentuar shqiptarë; pse jo edhe si shkruar e orator erudit i artikujve e fjalimeve entuziaste e manifeste të botëkuptimit të tij properëndimor, ku veçohet p.sh. fjalimi i tij në Universitetin e Harvardit, Cambridge Mass., me studentët shqiptaro-amerikanë në vitin 1960, i cili mund të konsiderohet

edhe si testamenti moral që ai i linte bashkëkombësve të vet në atdhe, apo mërgim për rolin dhe detyrimin e madh që duhet të marrë çdokush me kontributin intelektual e profesional ndaj zhvillimit e prosperitetit kombëtar. etj. Njeri i lëvizjeve dinamike, i fantazisë, i zhdërvjelltësisë, armik i



PROF. THOMA NASSI

qetësisë, i rutinës dhe plogështisë, artist me talent e intuitë të hollë për misionin e tij artistik e qytetar, promotor, aktiv e me një trysni të madhe përgjegjësie ndaj vetes. Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura është manifesti frymëzues i historisë së muzikës Shqiptare.



CEREMONIA E TRANSFERIMIT TË AUTORITETIT TË KOMANDËS

Italia merr komandën e grupit luftarak shumëkombësh të NATO-s në Bullgari

Italia mori komandën e grupit të betejës shumëkombëshe të NATO-s në Bullgari, në një ceremoni, më 17 tetor 2022, me pjesëmarrjen e presidentit bullgar Rumen Radev dhe ministrit të Mbrojtjes Dimitar Stoyanov, ministrit italian të Mbrojtjes Lorenzo Guerini dhe Komandantit Suprem të Aleatëve për Europën (SACEUR), gjeneral Christopher G. Cavoli. “Kjo është një ditë historike, sepse sot ne jemi dëshmitarë të transferimit tonë të parë të autoritetit të komandës së një grupi të ri beteje nga një aleat



tek tjetri”, - tha gjenerali Cavoli.

I krijuar në mars, grupi i betejës në Bullgari përbëhet nga afërsisht 100 trupa nga disa aleatë të NATO-s, duke përfshirë Bullgarinë, Greqinë, Italinë dhe Shtetet e Bashkuara, dhe elementë të ndryshëm manovrash, këmbësorie, mbrojtjeje ajrore, anti-tanke dhe inxhinierike. Është një nga tetë grupet luftarake shumëkombëshe të NATO-s; të tjerat janë në Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni, Rumania dhe Sllovaki. Këto grupe beteje janë shumëkombëshe dhe të gatshme për luftë, duke demonstruar forcën e

lidhjes transatlantike. Ata veprojnë së bashku me forcat mbrojtëse të vendit pritës, duke kryer ushtrime dhe aktivitete vigilance. Prania e tyre e bën të qartë se një sulm ndaj një aleati do të konsiderohet si një sulm ndaj të gjithë Aleancës. Grupet luftarake të NATO-s përbëjnë pjesë të përforcimit më të madh të mbrojtjes kolektive të NATO-s në një brez.

Italia tani kryeson grupin e betejës me Regjimentin e 82-të të Këmbësorisë “Torino”, i komanduar nga koloneli Francesco Alaimo.

“STEADFAST NOON”, 17-30 TETOR 2022

NATO fillon Stërvitjen Bërthamore vjetore

Forcat ajrore nga e gjithë NATO-ja do të ushtrorin aftësi parandaluese bërthamore, duke përfshirë dhjetëra avionë mbi Europën veriperëndimore, duke filluar nga 17 tetor 2022. Stërvitja, e cila zgjat deri më 30 tetor, është një aktivitet trajnimi rutinë, i përsëritur dhe nuk është i lidhur me ndonjë ngjarje aktuale botërore.

Stërvitja “Steadfast Noon” përfshin 14 vende dhe deri në 60 avionë të llojeve të ndryshme, duke përfshirë avionë luftarakë të gjeneratës së katërt dhe të pestë, si dhe avionë vëzhgimi dhe cisternë. Ashtu si në vitet e mëparshme, do të marrin pjesë bombarduesit amerikanë B-52 me rreze të gjatë; këtë vit, ata do të fluturojnë nga baza ajrore Minot në Dakotën e Veriut. Fluturimet stërvitore do të zhvillohen mbi Belgjikë, e cila është mikpritëse e stërvitjes, si dhe mbi Detin e Veriut dhe Mbretërinë e Bashkuar. Nuk përdoren armë të luftarake.

“Steadfast Noon”, organizohet nga një vend aleat i ndryshëm i NATO-s çdo vit. “Kjo stërvitje ndihmon për të siguruar që parandalimi bërthamor i Aleancës të mbetet i mbrojtur, i sigurt dhe efektiv”, - tha zëdhënësja e NATO-s, Oana Lungescu.

Koncepti i ri Strategjik i NATO-



s, i miratuar nga udhëheqësit aleatë në Samitin e Madridit në qershor e bën të qartë se qëllimi themelor i aftësisë bërthamore të NATO-s është ruajtja e paqes, parandalimi i detyrimit dhe frenimi i agresionit. Ai thekson se, për

sa kohë që ekzistojnë armët bërthamore, NATO do të mbetet një aleancë bërthamore. “Qëllimi i NATO-s është një botë më e sigurt për të gjithë; ne kërkojmë të krijojmë mjedisin e sigurisë për një botë pa armë bërthamore.”

GATISHMËRI, EDUKIM DHE TRAJNIM

Raundi i shtatë i bisedimeve të personelit ushtarak me Bashkimin Afrikan

Më 17-18 tetor 2022, Divizioni i Sigurisë Bashkëpunuese i NATO-s, nën kujdesin e Drejtorit të saj, gjeneralmajor Francesco Diella, mirëpriti një delegacion nga Bashkimi Afrikan për bisedimet ushtarake. Diskutimet u fokusuan në gatishmërinë, edukimin dhe trajnimin, pjesëmarrjen në stërvitje si dhe ngritjen e kapaciteteve dhe integrimin gjinor.

Në hapje të takimit, gjeneralmajor Francesco Diella, Drejtor i Divizionit të Sigurisë Bashkëpunuese, mirëpriti gjenerallejtënant Antonio Lamas Xavier, kreu i delegacionit të Bashkimit Afrikan (AU) dhe stafit të tij në edicionin e 7-të të bisedimeve NATO-AU. “Bazuar në Konceptin e ri Strategjik të NATO-s, ky takim është një mundësi për të çuar përpara udhëzimet e nxjerra në Samitin e Madridit për të rritur bashkëpunimin me partnerët tanë, përfshirë organizatat ndërkombëtare, si Bashkimi Afrikan. Duke punuar së bashku, ne mund të vazhdojmë të eksplorojmë zgjidhje të përbashkëta për sfidat e përbashkëta, duke zhvilluar njëkohësisht mundësi të reja që forcat e NATO-s dhe AU-së të marrin pjesë së bashku në stërvitje”, - theksoi ai.

Më pas, të dy delegacionet u angazhuan në diskutime mbi gatishmërinë, veçanërisht në lidhje me organizimin e Forcave Afrikane të Gatishmërisë. “NATO ka rritur përpjekjet e saj parandaluese dhe mbrojtëse në të gjitha fushat. Në tokë, ne po dislokojmë forca më thelbësore dhe të gatshme për luftim, ndërkohë që përmirësojmë gatishmërinë dhe aftësinë tonë për të përforcuar sipas nevojës dhe kur kërkohet. Gjatë 73 viteve të fundit, ne kemi mësuar gjithashtu mësimet të vlefshme për gatishmërinë dhe qëndrueshmërinë, të cilat janë thelbësore për organizata si kjo e jona”, - shtoi gjeneralmajor Diella.

Diskutimet u përqendruan gjithashtu në funksionalitetin, logjistikën, ndërtimin e kapaciteteve dhe mbështetjen për Bashkimin Afrikan, duke përfshirë në fushën e luftimit të pajisjeve shpërthyes të improvizuara, përmes ushtrimeve, edukimit dhe trajnimit. “Arsimi dhe trajnimi janë një shtyllë kyçe e bashkëpunimit tonë. Ne jemi gjithmonë të kënaqur të mirëpresim personelin e AU në shkollën tonë në Oberammergau ose në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s, kjo nuk është vetëm një mundësi për t’i informuar ata për NATO-n, por gjithashtu na lejon të angazhohemi në një shkëmbim konstruktiv për sigurinë dhe mbrojtjen”, - vuri në dukje Drejtor i Divizionit të Sigurisë Bashkëpunuese. Një fushë tjetër thelbësore e mbështetjes së NATO-s për Bashkimin Afrikan është ajri strategjik dhe transporti detar.

Delegacioni i NATO-s mori gjithashtu një informim mbi divizionin e Operacioneve të Mbështetjes së Paqes të Komisionit të AU, i cili bashkon politikën, udhëzimet, marrëveshjet, kornizat dhe mekanizmat për të ndihmuar në bashkimin e mekanizmave rajonale të paqes dhe sigurisë për t’u përgjigjur operacioneve të mbështetjes së paqes dhe sfidave të sigurisë.

Bisedimet e fundit të stafit ushtarak u mbajtën më 14-15 maj 2019 në Addis Abeba, Etiopi. Bisedimet vjetore u pezulluan për shkak të pandemisë së vazhdueshme COVID dhe kufizimeve të udhëtimit që pasuan. “Shpresojmë, ne mund të rifillojmë theksin vjetor të bisedimeve tona ushtarake. NATO mbetet plotësisht e përkushtuar për të zgjeruar marrëdhëniet e saj nga mbështetja në bashkëpunim me AU, veçanërisht në përpjekjet për të trajtuar sfidat e sigurisë në kufijtë e NATO-s”, - përfundoi gjeneralmajor Diella.

ROLI I NATO-S NË VERIUN E LARTË

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s thekson rëndësinë strategjike të Arktikut

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admirali Bauer ishte në Islandë, ku mori pjesë në Asambledën e Rrethit Arktik dhe u takua me ministrin e Punëve të Jashtme, Thórhís Kolbrún Reykjavíkur Gylfadóttir, shefin e Mbrojtjes, z. Jonas Allansson dhe ish-presidentin e Islandës z. Ólafur Ragnar Grímsson.

Admirali Bauer e nisi vizitën e tij duke takuar shefin e ri të Mbrojtjes, z. Jonas Allansson dhe e uroi atë për emërimin e fundit. “Ju bashkoheni me ne në një moment sfidues për sigurinë tonë. Rendi i bazuar në rregulla është çrrënjësor dhe NATO po përgjigjet duke zbatuar masa për të forcuar mbrojtjen tonë kolektive. Ne me siguri do të përfitojmë nga përvoja juaj në Kombet e Bashkuara dhe si specialist i Arktikut”, - theksoi kryetari. Me ta u bashkuan edhe z. Njall Trausti Fridbertsson, kreu i Delegacionit Islandez në Asambledën Parlamentare të NATO-s dhe Z. Gardar Forberg, Përfaqësuesi Ushtarak i NATO-s për Islandën. Duke u takuar me znj. Thórhís Kolbrún Reykjavíkur Gylfadóttir, ministrin e Punëve të Jashtme Islandeze dhe ish-Presidentin e Islandës z. Ólafur Ragnar Grímsson, admirali Bauer përsëriti rolin kyç

që luan Islanda në rajon, si aleat e NATO-s, por edhe si anëtare e Këshillit Arktik. Ai gjithashtu theksoi se kur Finlanda dhe Suedia të bashkohen me Aleancën tonë, shtatë nga tetë anëtarët e Këshillit Arktik do të jenë aleatë të NATO-s. “Me këtë nivel integrimi, ne do të jemi në gjendje të përcaktojmë më mirë rolin e NATO-s në Veriun e Lartë si dhe të përfitojmë nga më shumë asete në rajon”. Admirali Bauer më pas iu bashkua Asamblesë së Rrethit Arktik për të ndarë pikëpamjen e tij mbi mjedisin aktual të sigurisë dhe ndikimin e tij në Arktik. “Në këtë moment kyç për sigurinë globale, NATO do të bëjë atë që ka bërë më së miri në 73 vitet e fundit: bashkohet dhe përshtatet. Me forcë dhe unitet, ne do të vazhdojmë të pengojmë agresionin, të mbrojmë vlerat dhe interesat tona dhe t’i mbajmë njerëzit tanë të sigurt. Arktiku ka pasur gjithmonë një rëndësi strategjike për NATO-n si porta e dukshme për në Atlantikun e Veriut, duke pritur lidhje jetike tregtare dhe të komunikimit midis Amerikës së Veriut dhe Europës. Si e tillë, NATO do të bëjë gjithçka që mundet për të siguruar që Arktiku të mbetet i lirë dhe i hapur”, - theksoi ai.

Rasim Imami, pedagogu që përgatiti ndërlidhësit e ushtrisë

Dr. Asllan Zemani

Familja qytetare vlonjate, Imami

Familja e madhe qytetare vlonjate, Imami, është shumë e njohur në qytetin e pavarësisë, për kontributet patriotike që ka dhënë ky fis në periudhat e ndryshme historike për vendin tonë. Në dhjetëvjeçarin e tretë, të shekullit që shkoi, në një nga degët e këtij fisi, në gjirin e familjes së Ymer Imamit, do ta bënte akoma më të njohur, sidomos gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, por dhe më pas, në vitet lirisë së vendit tonë, në fushën ushtarake Rasim Imami, kolonel me karrierë të suksesshme në shërbimin e ndërlidhjes së Ushtrisë Shqiptare. Fisi Imami ka spikatur dhe ka qenë i dalluar për atdhetarizëm dhe ndjenjë e përkushtimit ndaj çështjes së lirisë dhe të Shqipërisë, por edhe për kulturën e talentin e tyre të veçantë. Më 1 gusht 1929 familja qytetare vlonjate Imami, u gëzua shumë për ardhjen në jetë të djalit të tyre, të cilin e quajtën Rasim, për të kujtuar e respektuar emrin e të parëve të tyre. Fëmijëria dhe rritja e tij ishte gjithmonë në përkujdesjen edhe të gjyshërve të tij që aq shumë e donin, të cilët e edukuan me dashuri dhe mirësi për njerëzit por edhe për qytetin dhe vendin e tij, duke i treguar edhe për luftërat e popullit tonë kundër pushtuesve të shumtë të vendit tonë.

Njëkohësisht, vështirësitë e shumta ekonomike të kësaj kohe, si të gjitha familjet e tjera të këtij qytetit, e rritën dhe e burrëruan më shumë Rasimin e vogël. Në kujdesin atëror të babait të tij, një arsimdashës i dalluar, i cili e edukoi atë, krahas të tjerave, edhe për dashurinë për shkollën e arsimit, ku Rasimi filloi, qysh në fillim të shtatorit të vitit 1936 me dëshirë të madhe, ciklin e ulët 7-vjeçar, që e mbaroi një vit pas pushtimit të vendit. Shkollat e Vlorës shqueshin jo vetëm për nivel të lartë të mësimdhënies, të disiplinës së rreptë, por edhe të edukimit me tradita të vryta të atdhetarisë shqiptare. Në të gjithë vitet e shkollës së arsimit të ulët Rasimi u dallua për rezultate shumë të larta por edhe për disiplinën e korrektë, në një shoqëri të mirë me të gjithë shokët dhe shoqet e klasës së tij. Në këto kohëra të vështira të vendit tonë, shpesh herë nga të rinj më të rritur, ai dëgjonte por nuk i kuptonte mirë bisedat e tyre për idetë komuniste, të cilat ishin tepër tërheqëse në ato kohë për një pjesë të madhe të rinisë, madje edhe të asaj europiane, e cila e përqafoi për hir të idealizmit, si rebelim romantik ndaj një bote të padrejtë.

Korrieri partizan 13-vjeçar

Ndërkohë në prag të mbarimit të viteve '30, ndonëse i ri fare, Rasimi shikonte shumë ushtarakë apo edhe civilë italianë, të cilët në qytetin e tij kryenin aktivitetin parapërgatitor për pushtimin e vendit. Natyrshëm këta "pushtues, apo sipas monarkut shqiptar, ndihmës të shtetit" ndikuan ndjeshëm edhe në mendjen apo ndërgjegjen e Rasimit, duke mbjellë elementët e parë të revoltës apo inatit kundër tyre. Në bisedat me shokët e tij të ngushtë, ata flisnin gjithmonë me urrejtje kundër pushtuesit por komentonin aksionet e njësiteve guerile në qytetin e Vlorës, lexonin me simpati traktet e ngjitura në shtylla, parullat e ndryshme të shkruara kundër fashizmit në mure etj. Me kalimin e kohës bie në kontakt me element antifashistë dhe nga simpatizantë të ideve komuniste u kthyen në aktivistë, e ndër ta shquhej Rasimi. Si aktivist sypatrembur, ai ka kryer një sërë aksionesh si në shpërndarje komunikatash apo traktesh, në grumbullimin e ndihmave për luftën, si dhe mori pjesë aktivisht në demonstrata antifashiste që zhvilloheshin në Vlorë. E gjithë familja Imami, duke i urreyer pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre, u lidh me LANÇ-in. Ndërsa Rasimi pranohet në radhët e rinisë komuniste dhe shquhet në grupet e aktivistëve duke i kryer rregullisht detyrat. Shkathësia në kryerjen e aksioneve, nuhatja për zbulimin e kurtheve të ngritura nga armiku zotërimi i artit të maskimit, aftësia për gjetjen e shtigjeve për daljen nga postbloqet e shumta të pushtuesit, ishin të gjitha këto cilësi e dukuri spikatëse të korrierit të qarkut të Vlorës, Rasim Imami. Korrieri partizan 13-vjeçar, mori pjesë me armë në dorë në luftë kundër pushtuesit fashist. Me formimin e BrXIIS, Rasimi u rreshtua në këtë njësi të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, përsëri me detyrën e korrierit të shtabit të saj. Ky pionier, më i gjatë se vërsnikët e tij, përballoi me pjekurinë e burrërinë e një të rrituri, ashpërsinë e betejave të shumta të BrXIIS, në krahinën e Dishnicës (Përmet), në zonën Skrapar-Berat, në Kurvelesh, gjatë bregut të detit Jon, në Vlorë dhe në zonën e Peqinit, në



Therepel, në Vokopojë, në Qafëshkozë, në Rehovë, në qafën e Kicokut e në Arrëz të Beratit, për mbrojtjen e drejtimit Berat-Këlcyre; luftimet në Kurvelesh, në grykën e Bënçës e të Salarisë, në Qafën e Kreshtës dhe në grykën e Kuçit (Shuri i Kuçit) me pushtuesit nazistë në dimrat e jashtëzakonshëm, si ato të viteve 1943-1944 apo edhe ai i vitit pasardhës, 1945.

Pionieri me uniformën e skënderbegasit

Menjëherë pas çlirimit të vendit, si të gjithë pionierët, që kishin luftuar me armë në dorë dhe ishin të rreshtuar në formacionet luftarake partizane për çlirimin e vendit, rifilluan arsimimin e tyre në shkollën e sapo formuar "Skënderbej", të cilën e mbaroi edhe Rasimi, tashmë në moshën 19-vjeçare me rezultate shumë të mira. Me vlerësime të larta në përfundim, Rasimi, u përzgjedh për të vijuar arsimimin e tij ushtarak pasionant në shkollën e këmbësorisë në Beograd. Duke marrë njohuritë e para ushtarake në degën e këmbësorisë, ai u burrërua me disiplinën, seriozitetin skrupuloz të stërvitjes së vogël taktike, duke përfunduar këtë shkollë me rezultate të shkëlqyera e po atë ditë mbi supet e tij u vendos grada e aspirantit. Pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë kthehet në atdhe dhe pas një qëndrimi të shkurtër kohor në dispozicion, në muajin shkurt 1948, së bashku me një grup të madh oficerësh apo aspirantësh, që kishin rezultate shumë të larta në shkollat që kishin përfunduar, nisët për studime, tashmë në ish-B. Sovjetik, në shkollën ushtarake të Kievit. Rasimi ishte shumë i prirur në lëndët e sakta shkencore, sepse në këto lëndë kishte edhe rezultatet më të larta gjatë arsimimit në shkollat që ai kishte përfunduar e për rrjedhojë u përpoq këtë radhë të merrte arsimimin e plotë në këtë shkollë me tradita, siç ishte Shkolla e Lartë Ushtarake e Kievit, në shkencën e ndërlidhjes, për telefoni, telegrafi apo edhe për radio, kryesisht për rrymat e dobëta. Me seriozitetin që e karakterizonte Rasimi ndiqte e përvetësonte leksionet e shumta për shkencën e ndërlidhjes, si bazat e teknikës së radios, bazat teknike të elektronikës, radiotelegrafia si dhe taktikë ndërlidhje apo edhe shumë lëndë të ndryshme formuese për oficerin ardhshëm të Ushtrisë Shqiptare, Rasim Imami. Përprkjetet e shumta në përvetësimin e leksioneve, pjesëmarrja aktive në seminarët e këtyre lëndëve apo zhdërvjellësia në përvetësimin punës, në praktikat e ndryshme të projektimit të linjave të rënda telefonike, por edhe në metodat mësimdhënëse për radiotelegrafi etj., u shpërblyen në fund me përfundimin e shkollës me rezultate të larta, që ai arriti.

Korrieri partizan që u bë ndërlidhësi shembullor

Kthimi në Shqipëri dhe çmallja me të gjithë të afërmit e tij u shoqërua edhe me gradimin e menjëhershëm të Rasimit me

gradën e nëntogerit, më 14 tetor 1951, sipas urdhrin të ministrit të Mbrojtjes, nr. 458. Ky gradim e gjeti nëntogerin e ri të emëruar në detyrën e komandantit të togës në batalionin e ndërlidhjes të DIK. Me fillimin në detyrën e re, Rasimi punoi me përkushtim e këmbëngulje për realizimin e detyrave të njëpasnjëshme që shtroheshin nga komanda e eprore. Një rëndësi të madhe i kushtoi sidomos përgatitjes dhe klasifikimit të radiotelegrafistëve e të ndërlidhësve që aq shumë kishin nevojë, kryesisht repartet e njësitë gjitharmëshe. Këtë detyrë, sa fisnike por edhe pasionante për komandantin e togës së ndërlidhjes, Rasimin. Arriti që të kishte rezultate të larta dhe në shtatorin e vitit 1953, pra vetëm pas dy vjetësh, Rasimi u gradua jashtë radhe me gradën e Togerit. Për rezultate të larta në përgatitjen politiko-ushtarake e fitimi i garave vjetore nga toga e ndërlidhësve të batalionit të ndërlidhjes si dhe profesionalizmin e drejtimit të stërvitjes së vogël u mendua dhe u propozua nga Drejtoria e Ndërlidhjes, që toger Rasimi, të emërohej në Regjimentin e Ndërlidhjes në detyrën e komandantit të kompanisë së ndërlidhjes. Edhe në këtë detyrë të vështirë, në përgatitjen e radiotelegrafistëve apo të përgatitjes së ndërlidhësve, për të përballuar stërvitjet e shumta që bënin njësitë gjitharmëshe në këtë kohë, togeri i përballoi me sukses, duke arritur rezultate të larta. Më pas, në vitet 1953-1954, u emërua në detyrën e komandantit të batalionit të radios po në Regjimentin e Ndërlidhjes, Tiranë. Dhe në këtë periudhë, me urdhrin nr. 469, datë 22 shtator 1956, të ministrit të Mbrojtjes, ndërlidhësi Rasim Imami u gradua me gradën kapiten. Në shtatorin e vitit 1957, në bazë të rezultateve të larta që kishte arritur në nënrepartet e repartet e ndërlidhjes, u përzgjedh, që përgatitja e tij të rritej e të thellohej për drejtimin deri të njësisë operative të armës së shërbimit të ndërlidhjes. Kështu për tre vjet rresht (1957-1961) ndoqi me përkushtim e seriozitet Akademienë e Ndërlidhjes në Leningrad (Sant-Peterburg), në ish-B.S. Gjatë arsimimit në këtë akademi, me urdhrin nr. 325, datë 22 gusht 1959, të ministrit të Mbrojtjes, akademisti Rasim Imami u gradua me gradën e Kapitenit I. Me përfundimin e Akademisë së Ndërlidhjes dhe kthimit në atdhe Rasim Imami u emërua në një sërë detyrash në shërbimin e ndërlidhjes në njësi të ndryshme të dislokuar në të gjithë territorin e vendit tonë si në BrIIK, në Ersekë, (1961-1969); në BrIT, në Zall-Herr, (1969-1973); pedagog ndërlidhje në Shkollën e Tankeve (1973-1975).

Pedagogu që spikati në profesionalizëm

Më kalimin e Shkollës së Bashkuar, në nivelin e arsimit të lartë të vendit, majori Rasim Imami u emërua në detyrën e pedagogut të ndërlidhjes si dhe zëvendësuesi i Katedrës së Ndërlidhjes në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, që nga marsi i vitit 1973 deri në shtatorin e vitit 1980. Krahas nivelit të lartë profesional që majori kishte, në rol të dorës së parë në përgatitjen e oficerëve të rinj i jepte edhe njohja shumë e mirë e gjuhës ruse e asaj gjermane.

Në këtë detyrë, që e kreu me përkushtim e ndjenjë përgjegjësie, si dhe me profesionalizëm spikatës që e karakterizonte atë, dha një kontribut të veçantë në përgatitjen e disa brezave të oficerëve të rinj ndërlidhës, duke i edukuar ata jo vetëm me dashurinë për shërbimin e ndërlidhjes dhe Forcave të Armatosura, për popullin e atdheun, por edhe në shprehitë e shëndosha profesionale dhe njohuritë për artin ushtarak modern, duke u dalluar për nivel të lartë të mësimdhënies. Pedagog Rasimi, ishte i respektuar e admiruar, jo vetëm për profesionalizmin e tij, por edhe për kulturën e spikatur qytetare, thjeshtësinë, komunikimin dhe marrëdhëniet e mira që mbante me studentët, shokët, kolegët, vartësit dhe eprorët e tij. Fazën përmbjellëse të karrierës ushtarake, major Rasim Imami e kreu në shërbimin e ndërlidhjes, në Forcat Vullnetare të Vetëmbrojtjes Popullore në detyrën e shefit të ndërlidhjes, tetor 1980-mars 1982, si dhe në Br40K në Tiranë, mars 1982-gusht 1984, ku del në pension të parakohshëm. Për kontributin që ka dhënë në shërbimin e ndërlidhjes së Ushtrisë Shqiptare është vlerësuar me urdhra e medalje nga Kuvendi i Shqipërisë, si Medalja e Çlirimit, Medalja e Trimërisë, Urdhri "Ylli i Kuq" Klasi III, Medalja e Shërbimit Ushtarak, Klasi III, Urdhri "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu", Klasi III, Medalja "10-vjet Ushtri Popullore", etj. Ai gëzoi statusin e nderuar të veteranit, si dhe kontribuoi dukshëm në Organizatën e Ushtarakëve në Rezervë e në pension me përkushtim dhe i respektuar nga të gjithë. Në nëntor 2021, Rasim Imami ndërroi jetë, duke lënë kujtimin e tij të mirë si një kuadër ushtarak i përgatitur, i ndershëm, besnik i çështjes së Atdheut dhe popullit nga gjiri i të cilës doli dhe të cilit i përket, por edhe si bashkëshort e prind korrekt dhe edukues për të dy djemtë e tij të mrekullueshëm.

Të moshuarit, libri historik i rrënjëve tona

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Tranzicioni i shoqërisë shqiptare po rëndon në radhë të parë mbi moshën e tretë. Lëvizja e të rinjve drejt emigracionit, tendencat për të krijuar familje bashkëkohore, familje të vogla apo të vetmuara në çifte, pa praninë e jetëdhënësve të tyre, kanë vështirësuar jetën e të moshuarve.

Marrëdhëniet midis brezave janë produkt historik, ato jo kurdo ndjekin të njëjtën kurbë dhe asnjëherë nuk janë të ngjashme dhe të pandryshueshme. Kur shoqëria ndryshon, kur kalon nga një sistem në një tjetër, nga një formë organizimi në një tjetër të re, ndryshon familja, organizmi i saj, mënyra e jetesës dhe marrëdhëniet midis brezave. Këtu nuk është fjala thjesht në papajtueshmërinë e të rinjve me të vjetrit në mendime, pasi lufta psikologjike midis brezave nuk është e sotme. Në çdo kohë, brezi i ri është në konflikt me brezin e vjetër, por çështja është që të shmangim përjashtimin e njëri-tjetrit. Familja e re, e quajtur moderne, duhet pranuar se po lëviz në drejtim të kundërt me familjen tradicionale, me normat dhe kriteret e ndërtimit të marrëdhënieve midis brezave. E keqja më e dukshme është mungesa e respektit midis pjesëtarëve në familjen shqiptare, ku është venitur ndjenja e përcjelljes së respektit për të moshuarit, e cila besoj se është një nga normat më të vjetra dhe më të pëlqyeshme në historinë e njerëzimit. Respekti njerëzor, detyrimi i fëmijës ndaj prindit, nuk mund të konsiderohet një normë e vjetruar, por një virtut moral, i cili jo vetëm nuk duhet të shuhet, por do të ishte mirë të ngjitej në një shkallë më të lartë. Respekti i fëmijës ndaj prindit është një borxh moral e shpirtëror që u duhet kthyer atyre, pasi të njëjtën gjë ka bërë dhe prindi ndaj fëmijës së vet.

Se si po sillet shoqëria shqiptare me të moshuarit e saj, vazhdon të mos përbëjë një temë sociale dhe të mos diskutohet publikisht. Kjo duhet të ndryshojë dhe për këtë nevojitet një përfaqësim më i fuqishëm i interesave të kujdesit për moshën e tretë. Sepse në ditët e sotme mund të parashikohet, që problemet e kujdesit për moshën e tretë do të vijnë në rritje. Dhe në këtë përfundim arrihet duke marrë parasysh situatën shumë të keqe të të moshuarve në ditët e sotme. Vetëm një pjesë e vogël e këtij grupimi pranohet në shtëpitë përkatëse të të moshuarve apo merr një trajtim të mirë mjekësor.

Kush ka përgjegjësi për prindërit?

Pyetje pavend, realitet i hidhur, një e vërtetë e trishtë, absurd shqiptar apo i huazuar?!

Përgjegjësitë nuk janë vetëm materiale dhe fizike. Ne kemi edhe përgjegjësi morale. Një prej tyre është respekti që duhet të kemi për njerëzit e tjerë dhe në veçanti për të moshuarit. Prej tyre ka buruar jeta jonë dhe e prindërve tanë. Ata janë mësuesit natyrorë të shoqërisë me vlerat më të mira.



Ata kanë jetuar shumë para nesh, kanë parë dhe kanë jetuar ngjarje të një kohe kur nuk kishim ardhur ende në këtë botë ne, krijesat e vjera për ta, që pas shumë vitesh nuk do të kthenim kokën pas. Ata kanë vuajtur dhe janë gëzuar në vendin të cilit i përkasim. Ata janë rrënjët tona sepse na përcjellin

ndjejmë përgjegjësinë për t'u kujdesur për ta. Babai dhe nëna janë përkushtuar pafundësisht për të na dhënë jetën që kemi sot, një jetë plot mundësi, rehati dhe privilegje. Ndërkohë që ata plaken, është më se e nevojshme që ne, fëmijët e tyre, ta kthejnë pas këtë favor dhe të kujdesemi e t'i duam ata, pa kushte.

si të pranojmë të tjerët, e mbi të gjitha kanë qenë mbështetja jonë më e fortë. Pa sakrificën e tyre që ka zgjatur me vite, ne nuk do të ishim të aftë të ishim këta që jemi. Respekti dhe kujdesi për të moshuarit fillon me prindërit tanë.

deri këtu dhe kanë mësuar kaq shumë, ne kemi përgjegjësinë që të mësojmë nga kjo urtësi.

Ata na duan në mënyrë të pakushtëzuar

Pavarësisht se çfarë ke bërë në jetë, se cili je bërë dhe se ku jeton, prindërit e tu të duan në mënyrë të pakushtëzuar. Patjetër që ndonjëherë ata mund të jenë mërzitur me ty, por ti do të ngelesh fëmija i tyre. Kjo lloj dashurie e pakushtëzuar është e vështirë të gjendet në raporte të tjera.

Prezenca e prindërve të tu të jep shpresën dhe fuqinë për t'u qetësuar e për të vazhduar.

Sakrifica

Nëse do të arrijmë të shohim pas, prindërit tanë kanë sakrifikuar vazhdimisht që të na shohin mirë dhe të lumtur. Ata janë siguruar që të kemi të gjithë rehatinë e kushtet e nevojshme. Kanë bërë gjithçka që të shohin buzëqeshjen në fytyrat tona, na kanë parë në momentet kur kemi dështuar e kur kemi arritur suksese, dhe i kanë kujtuar vetes së tyre se për çfarë po luftojnë.

Duhet të kujdesemi për ta sepse e ardhmja e tyre është e pasigurt.

Vendose veten në vendin e një personi të moshuar. Kur e kupton se trupi yt po dobësohet e se fuqitë po të lënë, është e vështirë që të përballësh me pasigurinë që mund të ndjesh për të ardhmen, qoftë mendërisht ashtu edhe fizikisht. Të moshuarit mund të kenë shumë gjëra në mendjen e tyre, që nuk janë të aftë t'i shprehin. Ne kemi përgjegjësinë që t'u japim ndihmën për të cilën kanë nevojë për t'i ndihmuar që të jetojnë në paqe pjesën tjetër të jetës. Ndaj kujdesu që të jesh ajo dritë dhe dashuri.

Dhe unë, ti, ne do jemi pjesë e kësaj gjenerate një ditë.



traditat e familjes ku lindim. Të moshuarit janë si një libër historie i hapur. Ata tregojnë kohën që kaloi, vlerat e kombit, ngjarje të rëndësishme, jetën e vendit në 100 vjet. Teksa shohim prindërit tanë që plaken, brenda nesh

Pse duhet kujdesi ndaj moshës së tretë?

Sepse bëhet fjalë për nënën dhe për babanë tonë. Ata janë mësuesit tanë të parë. Ata na mësojnë si të duam, si të kujdesemi, si të japim, si të falim,

Urtësia

Të moshuarit janë një enciklopedi me dije dhe më shumë urtësi. Eksperienca që ata kanë, e stuhitë që kanë kaluar gjatë jetës së tyre, bën që të kenë një urtësi të çmueshme. Ata kanë ardhur

Mundësi të reja bashkëpunimi në sektorin e energjisë në rajonin euro-mesdhetar

Më 17 tetor, Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (EESC) mbajti një konferencë mbi gjeopolitikën e strategjive të energjisë në rajonin euro-mesdhetar. E organizuar së bashku me Këshillin Kombëtar Italian për Ekonominë dhe Punën (CNEL) në Romë, konferenca nënvizoi potencialin e vendeve të fqinjësisë jugore të BE-së si prodhues të hidrogjenit të gjelbër, veçanërisht tani në dritën e luftës në Ukrainë. Zona mund të bëhet një lojtar kyç në sektorin e energjisë në dobi të të gjithë aktorëve të përfshirë.

Armatimi i energjisë i shkaktuar nga pushtimi rus i Ukrainës ka ndryshuar ndjeshëm arkitekturën e tregut evropian të energjisë. Është bërë e qartë se energjia është një shtyllë thelbësore e sovranitetit të BE-së.

Lufta në Ukrainë e ka vendosur energjinë në thelb të marrëdhënieve euro-mesdhetare. Ne duhet të rrisim bashkëpunimin tonë në të gjithë rajonin dhe të sigurojmë një tranzicion të suksesshëm drejt një sistemi të qëndrueshëm energjetik i cili gjithashtu do të rrisë sigurinë energjetike dhe autonominë tonë. Reforma të tilla mund të kryhen vetëm me përfshirjen e plotë të shoqërisë civile të organizuar. Ne kemi nevojë për solidaritet brenda BE-së dhe me vendet e treta në këtë fushë, tha presidentja e EESC Christa Schweng.

Në të njëjtën linjë, Patrizia Toia, deputete e Parlamentit Evropian iu referua luftës ruse kundër Ukrainës, e cila tregoi varësinë e shteteve evropiane nga nafta dhe gazi rus. Ajo vuri në dukje rëndësinë e bashkëpunimit brenda zonës euro-mesdhetare: Shtetet Anëtare të BE-së duhet të forcojnë lidhjet e tyre me Fqinjësinë Jugore për të ofruar transportues alternativ të qëndrueshëm të energjisë. Potenciali i lartë i energjisë së rinovueshme të rajonit do të jetë i dobishëm për BE-në për të arritur objektivat e saj ambicioze të



dekarbonizimit duke shmangur varësitë e reja të energjisë.

Duke qenë se Mesdheu Jugor është identifikuar si një nga tre korridoret kryesore për importet e hidrogjenit të gjelbër nga BE, presidenti i Këshillit Kombëtar Italian, Tiziano Treu, nënvizoi nevojën për bashkëpunim të mëtejshëm: Bashkëpunimi ndërmjet vendeve të zonës euro-mesdhetare është e rëndësishme të krijohet një partneritet i drejtë për zhvillim të qëndrueshëm bazuar në vlerat e përbashkëta të solidaritetit dhe afërsisë. Ai shtoi gjithashtu: Strategjitë e energjisë, për të qenë efektive, duhet të rrjedhin nga një veprim i përbashkët dhe i përbashkët i BE-së, para së gjithash, me

qeveritë kombëtare evropiane.

Grammenos Mastrojeni, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Lartë i ngarkuar për Energjinë dhe Veprimin Klimatik, Unioni për Mesdheun, theksoi: Asnjë nga vendet në rajonin euro-med – as më të pasurit – nuk ka burime të mjaftueshme për të përballuar një krizë me një ritëm të tillë dhe amplituda më vete. Por së bashku bëjmë: dhe nëse e kuptojmë atë, përveç përballjes me efektshmëri të ndryshimeve klimatike, ne do të ndërtojmë atë ekonomi të përbashkët dhe më të drejtë që më në fund mund të arrijë një paqe të qëndrueshme në të gjitha cepat e rajonit tonë.

Në seancat që pasuan, pjesëma-

rrësit diskutuan se si furnizuesit e rinj të energjisë mund të reduktojnë varësinë nga furnizuesit individualë dhe debatuan për zbutjen e ndikimit ekonomik dhe social të çmimeve të larta të energjisë.

Në përfundim të ngjarjes, Ioannis Vardakastanis, anëtar i EESC dhe president i Komitetit Vazhdues të EESC Euromed, bëri thirrje për promovimin e energjisë së rinovueshme, pasi ajo ka potencialin për të mbështetur rritjen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, tregtinë dhe bashkëpunimin në të gjithë rajonin e Mesdheut.

Rezultati i debateve të konferencës do të ushqejë në një raport informacioni mbi politikën dhe strategjitë energjetike në rajonin euro-mesdhetar, të përgatitur nga Seksioni i Marrëdhënieve me Jashtë të KESE-së (REX).

Urgjenca e energjisë: Komisioni bën propozime shtesë për të luftuar çmimet e larta të energjisë dhe për të garantuar sigurinë e furnizimit

Komisioni Evropian po vazhdon punën e tij për të adresuar çmimet e larta të energjisë dhe për të rritur sigurinë e furnizimit dhe gatishmërinë për dimër duke propozuar një rregullore të re emergjente. Masat e propozuara do të mundësojnë blerjen e përbashkët të gazit, futjen e mekanizmave kufizues të çmimeve në shkëmbimin e gazit TTF dhe masa të reja për përdorimin transparent të infrastrukturës, si dhe solidaritetin midis Shteteve Anëtare, shoqëruar me përpjekje të vazhdueshme për të reduktuar kërkesën për gaz. Këto

masa të reja do të përmirësojnë stabilitetin në tregjet evropiane të gazit këtë dimër dhe më tej dhe do të ndihmojnë gjithashtu në zbutjen e mëtejshme të presionit të çmimeve të ndjerë nga qytetarët dhe industria evropiane, duke siguruar një treg të brendshëm funksional. Rregullorja varet nga grumbullimi i kërkesës së BE-së dhe blerja e përbashkët e gazit për të negociuar çmime më të mira dhe për të zvogëluar rrezikun që shtetet anëtare të tejkalojnë njëra-tjetrën. Ai gjithashtu avancoi punën për të krijuar një standard të ri të çmimit të LNG-së, një kornizë për të propozuar një mekanizëm korrigjimi të çmimit për të vendosur një kufi dinamik çmimi për transaksionet në shkëmbimin e gazit TTF dhe një hallkë të përkohshme ose mburojë për të parandaluar rritjet ekstreme të çmimeve në tregjet e derivateve. Rregullat e paracaktuara të solidaritetit midis Shteteve Anëtare në rast të mungesës së furnizimit dhe një propozim për të krijuar një mekanizëm për shpërndarjen e gazit për shtetet anëtare të prekura nga një emergjencë e furnizimit me gaz rajonal ose të Bashkimit janë gjithashtu pjesë në propozimet të Komisionit. Për më tepër, Komisioni do të kryejë një vlerësim të nevojave për REPowerEU për të përshpejtuar tranzicionin e energjisë së pastër dhe për të shmangur fragmentimin në tregun e vetëm. Ai po propozon gjithashtu një përdorim fleksibël të synuar të financimit të Politikës së Kohezionit për të trajtuar ndikimin e krizës aktuale të energjisë tek qytetarët dhe bizneset.

Pse siguria kibernetike në BE duhet të ketë rëndësi për ju?

Nga të dhënat e vjedhura te sistemet spitalore të bllokuara: sulmet kibernetike mund të kenë pasoja të rrezikshme.

Transformimi dixhital i ekonomisë dhe shoqërisë është përshpejtuar vitet e fundit, duke krijuar mundësi por edhe sfida.

Sulmet kibernetike janë përpjekje për të keqpërdorur informacionin, duke e vjedhur, shkatërruar ose ekspozuar atë dhe synojnë të prishin ose shkatërrojnë sistemet dhe rrjetet kompjuterike.

Siguria kibernetike përfshin sigurinë e informacionit dhe komunikimit, teknologjinë operacionale dhe platformat e TI-së të nevojshme për të garantuar sigurinë e sistemeve dixhitale.

Kërcënimet kibernetike në BE: kosto personale dhe shoqërore

Përdorimi i zgjidhjeve dixhitale ka qenë prej kohësh në rritje dhe puna në distancë, blerjet në internet dhe mbajtja e kontakteve në internet u rritën ndjeshëm gjatë bllokimit. Këto zgjidhje mund të përfitojnë konsumatorët dhe të mbështesin ekonominë dhe rimëkëmbjen pas Covid. Megjithatë, ka pasur një rritje korresponduese në aktivitetet e dëmshme kibernetike.

22.3 miliardë pajisje të vlerësuara të përdorimit të internetit të gjërave deri në vitin 2024.

Sulmuesit mund të përdorin faqe interneti phishing dhe email me lidhje keqdashëse dhe bashkëngjitje për të vjedhur informacione bankare ose për të shantazhuar organizatat pasi të bllokohen sistemet dhe të dhënat e tyre të IT.

Një hapësirë e sigurt kibernetike është baza për tregun e vetëm dixhital të BE-së: mundëson zgjidhje dhe zhblokimin e potencialit të saj të plotë duke i bërë njerëzit të sigurt në internet. Indeksi i Ekonomisë



dhe Shoqërisë Dixhitale 2019 tregoi se shqetësimet e sigurisë kufizuan ose penguan 50% të përdoruesve të internetit në BE të kryejnë aktivitete në internet. Indeksi i vitit 2020 tregoi se 39% e qytetarëve të BE-së që përdornin internetin përjetuan probleme të lidhura me sigurinë.

5.5 trilion euro është kostoja vjetore e kimit kibernetik në ekonominë globale për vitin 2020, që është dyfishi i vlerës së vitit 2015 (sipas Komisionit Evropian).

Dëmi i shkaktuar nga sulmet kibernetike shkon përtej ekonomisë dhe financave, duke prekur themelet shumë demokratike të BE-së dhe duke kërcënuar funksionimin bazë të shoqërisë.

Shërbimet thelbësore dhe sektorët kri-

tikë si transporti, energjia, shëndetësia dhe financat, janë bërë gjithnjë e më të varur nga teknologjitë dixhitale. Kjo, së bashku me shtimin e objekteve fizike të lidhura me Internetin e gjërave, mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta, duke përfshirë bërjen e sigurisë kibernetike një çështje jete a vdekjeje.

Nga sulmet kibernetike ndaj spitaleve, duke shkaktuar shtyrjen e procedurave urgjente mjekësore, te sulmet në rrjetet e energjisë dhe furnizimin me ujë - sulmuesit po kërcënojnë furnizimin e shërbimeve thelbësore. Dhe ndërsa makinat dhe shtëpitë bëhen gjithnjë e më të lidhura, ato mund të kërcënohen ose shfrytëzohen në mënyra të paparashikuara.

Sulmet kibernetike, të vendosura për

shembull me dezinformim, presion ekonomik dhe sulme të armatosura konvencionale, po testojnë qëndrueshmërinë e shteteve dhe institucioneve demokratike, duke synuar drejtpërdrejt paqen dhe sigurinë në BE.

Siguria kibernetike në BE

Bizneset dhe organizatat në BE shpenzojnë dukshëm më pak për sigurinë kibernetike sesa homologët e tyre amerikanë. Bashkimi Evropian ka punuar për të forcuar sigurinë kibernetike. Në maj 2022, negociatorët e Parlamentit dhe Këshilli arritën një marrëveshje mbi Direktivën NIS2, të cilat janë rregulla gjithëpërfshirëse për të forcuar qëndrueshmërinë në mbarë BE-në.

“Ne duhet të veprojmë dhe t’i bëjmë bizneset, qeveritë dhe shoqërinë tonë më elastike ndaj operacioneve armiqësore kibernetike”, - tha Bart Groothuis (Rinew, Holandë), eurodeputeti përgjegjës për drejtimin e rregullave të reja përmes Parlamentit.

Në një debat plenar me zëvendëspresidentin e Komisionit, Schinas, eurodeputetët kërkuar më shumë ambicie të BE-së në sigurinë kibernetike dhe në mbrojtjen e infrastrukturës kritike.

Ata argumentuan në lidhje me incidentin e fundit “Nord Stream”, për të cilin thonë se ka zbuluar brishtësinë e infrastrukturës së BE-së dhe theksuan rrezikun e sulmeve kibernetike, duke treguar rastet që prekin një kompani transporti në Danimarkë dhe sistemin e kujdesit shëndetësor në Irlandë. Sipas mendimit të

tyre, BE-ja ka nevojë për një legjislacion më ambicioz për të siguruar infrastrukturën kritike që duhet të shkojë përtej propozimeve tashmë në diskutim (një ligj për elasticitetin e infrastrukturës kritike dhe rregullat e reja të sigurisë kibernetike).

Eurodeputetët kërkuar gjithashtu më shumë detaje mbi paketën e Mbrojtjes së Demokracisë të shpallur nga presidentja e Komisionit Ursula von der Leyen, në fjalimin e saj për gjendjen e Bashkimit dhe pyetën se si institucionet e BE-së do të trajtonin rastet e dyshuara të spiunazhit. Disa folës ngritën rëndësinë e mbrojtjes së infrastrukturës së gazit natyror të lëngshëm, ndërsa të tjerë iu referuan ndikimit të qeverive të huaja keqdashëse në infrastrukturën e rëndësishme dhe se si mbrojtja e tyre duhet të koordinohet me NATO-n.

Nënkryetari i Komisionit Schinas tha se epoka e naivitetit dhe pafajësisë së Europës tani ka përfunduar dhe se legjislacioni në diskutim do ta pajisë Europën me një “mburojë” të paprecedentë kundër kërcënimeve. Ai gjithashtu pranoi se nevojitet akoma më shumë punë për të rritur qëndrueshmërinë, veçanërisht kundër kërcënimeve të mbështetura nga shteti.

Lidhur me kërcënimet hibride, Schinas fajësoi regjimet autoritare për instrumentalizimin e vuajtjeve njerëzore, duke kanalizuar migracionin drejt territorit të BE-së dhe theksoi përpjekjet e ndërmarrja nga BE për t’iu përgjigjur. Ai theksoi gjithashtu punën e bërë nga Komiteti Special i PE-së për Ndërrhyrjen e Jashtme në të gjitha Proceset Demokratike në Bashkimin Evropian dhe konfirmoi se paketa e Mbrojtjes së Demokracisë do të përfshijë propozime për të trajtuar dezinformimin.

Lufta e Rusisë në Ukrainë hyri pa asnjë fitues të qartë ushtarak në horizont. Ajo që filloi si një luftë e manovrave të pritshme të guximshme ruse, e shoqëruar me një fushatë paralizuese të hapësirës ajrore dhe kibernetike, ka degjeneruar në një duel masiv tuba-raketë artilerie, një betejë e stilit të Luftës së Parë Botërore në një fushë beteje të kufizuar kryesisht në rajonin e Donbasit lindor dhe përgjatë kufirit ukrainas në veri dhe perëndim të Krimesë.

Megjithëse është e rëndësishme të tregohet kujdes në nxjerrjen e ndonjë përfundimi madhor, disa shenja të fuqishme për të ardhmen e luftës mund të rrjedhin nga ky konflikt.

Operacione urgjente të robotizuara me goditje të thellë

Në nivelet strategjike dhe operacionale të luftës, fushata ruse e hapësirës ajrore tregon një prirje të vazhdueshme drejt rritjes së robotizimit të sistemeve me goditje të thella. Përdorimi i gjerë i raketave lundruese dhe balistike të drejtuara me saktësi, me rreze të gjatë veprimi, i dha Rusisë aftësinë për të goditur një gamë të gjerë objektivash me vlerë të lartë pa përdorimin e një flote avionësh luftarakë të drejtuar nga rusët. Në fakt, flota e bombarduesve strategjike rusë veprimi si një platformë nisjeje për raketat e lundrimit me rreze të gjatë dhe armët e rastësishme hipersonike. Vlen të përmendet përdorimi i gjerë i raketave të lundrimit me rreze të gjatë të lëshuar nga toka dhe deti, si dhe lëshimi i raketave balistike me rreze të shkurtër veprimi, drejtuar me saktësi (SRBM) për të goditur objektiva me vlerë të lartë.

Ky zhvillim nuk është i paprecedentë: Republika Islamike e Iranit përdori sisteme të ngjashme gjatë fundit të verës 2019 dhe kreu një bombardim preciz SRBM të një aeroporti të SHBA-së në Irak gjatë janarit 2020. Ndërkohë, Marina dhe Forcat Ajrore të SHBA-së kanë përdorur gjerësisht raketa lundrimi me rreze të gjatë me sulm tokësor (LACM). Kjo filloi me fushatën ajrore të NATO-s kundër Serbisë në vitin 1995. Tani përhapja e kësaj aftësie të robotizuar për goditje të thellë është përhapur në aktorët kryesorë ushtarakë në Euro-Azi dhe periferinë e saj.

Zhvillimi i gjeneratës së ardhshme të sistemeve të goditjes me rreze të gjatë nga Shtetet e Bashkuara, Kina dhe Rusia, duke përfshirë mjetin rrëshqitës me lëvizje raketash (BGV) dhe raketën hipersonike të lundrimit (HCM) - demonstroi një fushatë shumë më të dëmshme dhe të qëndrueshme të bombardimeve jo bërthamore.

Superioriteti i zjarrit në fushëbetejë kundrejt superioritetit ajror

Karakterit i fushëbetejës ruso-ukrainase ka zbuluar disa tipare interesante. Së pari, shpërndarja masive e municioneve taktike anti-armaturë dhe anti-ajrore ka imponuar një konsumim shumë të lartë ndaj forcave tokësore dhe ajrore që nuk mbroheshin nga një gamë e gjerë kundërmasash individuale dhe kolektive. Kjo përhapje e armëve të drejtuara kundër ajrore i kishte mohuar Forcave Ajrore ruse mundësinë për të fituar epërsi ajrore operacionale dhe taktike mbi fushën e betejës.

Së dyti, lufta ka dëshmuar shfaqjen e plotë operacionale të komplekseve të zjarrit të zbulimit ukrainas dhe rus - sistemet me unazë të mbyllur që bashkojnë sistemet robotike të mbikëqyrjes ajrore me tuba dhe artileri raketore, të cilat mund të përdorin municione të drejtuara me saktësi (PGM). Këto sisteme artilerie të gjeneratës së re plotësohen tani nga përdorimi i një numri gjithnjë e më të madh municionesh brendhës që mund t'i ofrojnë këmbësorisë në të njëjtën kohë inteligjencën mbi kodër dhe një aftësi të shpejtë goditjeje direkte. Një aluzion i mëtejshëm i kësaj veçorie të re të luftës së kombinuar të armëve të shekullit të njëzetë e një ishte përdorimi i suksesshëm i këtyre sistemeve nga forcat e armatosura të Azerbajxhanit gjatë luftës së tyre të shkurtër të vitit 2020 kundër forcave armene të ngulitura dhe të blinduara shumë. Ky sistem i rafinuar i zjarrit indirekt ka zëvendësuar kryesisht përdorimin e avionëve luftarakë të armatosur me PGM për të ofruar mbështetje të afërt dhe të drejtpërdrejtë ajrore për forcat tokësore - një ndryshim i nxitur nga prania e sistemeve të mbrojtjes ajrore të përhapura, të lëvizshme dhe të lidhura në internet.

Lufta ruso-ukrainase mund t'i përgjigjet pyetjes nëse përdorimi i municioneve të drejtuara dhe mjeteve luftarake robotike i ka kthyer fuqi disproporcionale mbrojtjes taktike (jo ndryshe nga rrethanat ushtarake me të cilat u përballën ushtritë europiane në verën e vitit 1914). Ofensiva taktike duhet të rindërtohet për t'iu përgjigjur një fushëbeteje ku tanku kryesor i betejës dhe kasta e tij mbështetëse e mjeteve luftarake të blinduara janë të cenueshme ndaj zbulimit dhe shkatërrimit të shpejtë nga sistemet robotike.

Përgjigja mund të zbulohet gjatë luftës aktuale ruso-ukrainase. Këtë fund të verës, ukrainasit mund të fitonin epërsi ndaj zjarrit ndaj një force të armatosur të kombinuar ruse të dëmtuar shumë keq - jo ndryshe nga disfata izraelite e Ushtrisë Egjiptiane në Sinai (PDF) gjatë Luftës Gjashtëditore të vitit 1967, duke demonstruar kështu se forcat e blinduara tradicionale kanë një rol të madh në të ardhmen e operacioneve të armëve të kombinuara. Dizajni i mjeteve luftarake të blinduara të ardhshme mund të ndryshohet rrënjësisht me përdorimin e gjerë të mjeteve luftarake pa pilot për të paraprirë dhe komplimentuar përdorimin sulmues të sistemeve të drejtuar të tyre, më të mëdha dhe shumë më të shtrenjta. Ky koncept po eksplorohet fuqishëm nga forcat ajrore në formën e zhvillimit të avionëve luftarakë gjithnjë e më autonome për të

A do të zëvendësojë fuqia e robotizuar, fuqinë ajrore të drejtuar?



Një fregatë ruse lëshon një raketë lundruese Kalibr në një objektivi ukrainas nga Deti i Zi, 15 qershor 2022. Foto nga Ministria e Mbrojtjes e Rusisë/Reuters

vepruar si "krahë besnikë" për avionët luftarakë të pilotuar.

Fushata ruse e bombardimeve me raketa me rreze të gjatë veprimi është kufizuar rëndë nga inventarizimi i saj mjaft i vogël i paraluftës dhe mungesa e kapacitetit industrial për të prodhuar në masë këto armë shpejt. Në përgjithësi, fushata e

bombardimeve strategjike ruse nuk ka qenë vendimtare. Nga ana tjetër, NATO dhe fuqitë e mëdha të Azisë do të marrin parasysh cenueshmërinë ekstreme të infrastrukturës së tyre kritike ndaj sulmeve me rreze të gjatë PGM. Një nga pyetjet urgjente të politikës së mbrojtjes është se si NATO dhe aleatët aziatikë të Uashingtonit duhet t'i përgjigjen këtij rreziku të qartë dhe aktual. Për ta bërë infrastrukturën kritike të qëndrueshme ndaj bombardimeve precize, për shembull, Shtetet e Bashkuara, aleatët dhe partnerët e saj duhet të konsiderojnë vendosjen e një pjese të kapacitetit të tyre të prodhimit industrial ushtarak, veçanërisht instrumenteve të robotizuara të luftës, nën tokë për të plotësuar çdo investim të madh në sistemet e mbrojtjes ajrore.

Peter A. Wilson është një studiues i lartë i sigurisë kombëtare në korporatën jofitimprurëse, jopartiake RAND dhe jep mësimë mbi politikën e sigurisë kombëtare dhe historinë e inovacionit teknologjik ushtarak në Institutin "Osher Lifelong Learning". Kjo kumtesë fillimisht u shfaq në Këshillin Atlantik më 30 gusht 2022.

SHKENCË

NASA është gati të thyejë barrierën e zërit në një mënyrë të re

Shtatëdhjetë e pesë vjet më parë, një bum zanor gjëmoi për herë të parë mbi shkretëtirën e lartë të Kalifornisë.

Një grup i vogël studiuesish nga Komiteti Këshillimor Kombëtar për Aeronautikën (NACA) - organizata paraardhëse e NASA-s - ishin të parët që dëgjuan kërcitjen e bubullimës që vinte nga avioni raketor "Bell X-1" që fluturonte më shpejt se shpejtësia e zërit.

Ishte 14 tetor 1947 dhe ekipi i përbashkët X-1 i NACA-s, Forca Ajrore dhe inxhinierët e pilotët e "Bell" kishin thyer pengesën e zërit - një mur imagjinar në qiell, disa thanë se ishte e pamundur të depërtohej.

Tani, novatorët aeronautikë me misionin "Quesst" të NASA-s janë gati të thyejnë përsëri barrierën e zërit, vetëm se këtë herë në një mënyrë shumë të ndryshme që mund të na mundësojë që të gjithë në një ditë të udhëtojmë nëpërmjet ajrit po aq shpejt sa çdo pilot i "X-1" fluturonin një supersonik.

"Ai fluturim i parë supersonik ishte një arritje kaq e jashtëzakonshme, dhe tani ju shikoni se sa larg kemi arritur që atëherë. Ajo që ne po bëjmë tani është kulmi i punës shumë të madhe të tyre", - tha Catherine Bahm, një inxhinierë aeronautike në Qendrën Kërkimore të Fluturimeve Armstrong të NASA-s në Kaliforni.

Bahm është menaxher i projektit "Low Boom Flight Demonstrator". Ekipi i saj është përgjegjës për projektimin dhe ndërtimin e X-59, aeroplanit eksperimental të NASA-s që është pjesa qendrore e "Quesst".

Nëpërmjet "Quesst", NASA planifikon të demonstrojë se X-59 mund të fluturojë më shpejt se zëri pa gjeneruar zhurmën tipike të zërit që çuan në ndalimin e fluturimit supersonik mbi tokë në 1973.

Plani përfshin fluturimin e X-59 mbi disa komunitete për të vëzhguar se si njerëzit reagojnë ndaj "goditjes" më të qetë të zërit që prodhon, nëse dëgjojnë diçka. Përgjigjet e tyre do të ndahen me rregullatorët të cilët më pas do të konsiderojnë shkrimin e rregullave të reja për të hequr ndalimin.

Dhe kur kjo të ndodhë, do të shënojë një tjetër moment historik në fluturim, duke hapur potencialisht një epokë të re në udhëtimin ajror, ku pasagjerët e linjave ajrore mund të hipin në një avion supersonik në kohën e mëngjesit në Los Anxhelos për të bërë një rezervim për drekë në qytetin e Nju Jorkut.

Nga atëherë e deri tani

Ëndrra e udhëtimit komercial supersonik nuk ishte në mendjen e kapitenit të Forcave Ajrore Chuck Yeager, kur ai pilotoi X-1 "Glamorous Glenn" në 1947, në fluturimin historik pas "1 Mach", një matje se sa shpejt është fluturimi në raport me shpejtësinë e zërit.

Kaluan vite përpara se një transport supersonik i SHBA-së - i njohur gjerësisht si SST - të propozohej nga Presidenti John F. Kennedy në qershor 1963, pak pasi Europa shpalli planet e saj për "Concorde", aeroplani më i shpejtë se zëri që operoi përfundimisht nga 1976 në 2003.

SHBA më vonë ndaloi projektin SST në 1971 dhe ndaloi fluturimin supersonik mbi tokë në 1973.

Kërkimet vazhduan në fluturimin supersonik për arsye ushtarake dhe thjesht shkencore. Aeroplanët X që pasuan X-1 i shtynë kufijtë e fluturimit më lart dhe më shpejt, dhe novatorët aeronautikë të NASA-s ishin aty në çdo hap.

Mjetet gjithnjë e më të avancuara të kompjuterit dhe kërkimit të tunelit të erës që ata përdorën i shtuan njohuritë e tyre.

Duke zvogëluar zhurmën

Gjatë rrugës, studiuesit fituan një kuptim më të madh se si avionët krijojnë bume zanore dhe e kthyen në vëmendjen e tyre idenë e uljes së intensitetit të bumit të zërit duke manipuluar formën e aeroplanit.

Kjo ide u testua gjatë fluturimit nga programi "Shaped Sonic Boom Demonstration" i NASA-s, gjatë viteve 2003-2004. Ai përdori një avion "Northrop F-5E", trupi i të cilit u modifikua për t'i dhënë një formë të krijuar për të prodhuar zhurmë më të qeta të zërit.

Funksionoi

Me X-59 dhe teknologjinë e tij pa zhurmë, supersonike, të ndër-
tuar mbi gjithçka që është mësuar që kur X-1 provoi për herë të parë

se ishte e mundur të shkohej përtej "Mach 1", NASA shpreson t'i mundësojë industrisë që të bëjë fluturim më të shpejtë se zëri të disponueshëm për të gjithë.

"Ne kemi qenë të ngecur me avionët tanë në rreth "0,8 Mach" për pothuajse 50 vitet e fundit, kështu që të qenit në gjendje të arrijmë atje, shumë më shpejt është ende një lloj ëndrrë e paplotësuar", - tha Peter Coen, i NASA-s. menaxher i integritit të misionit për "Quesst".


Ekziston një shaka e vjetër se si X-1 theu barrierën e zërit dhe NASA është përpjekur ta rregullojë atë që atëherë. Coen nuk e sheh kështu. Në vend të kësaj, pengesa e re

për fluturimin supersonik është kufiri i shpejtësisë për shkak të efektit negativ të zhurmës së zërit, tha ai.

"Me X-59 që fluturon në misionin "Quesst", mendoj se jemi gati të thyejmë edhe një herë pengesën e zërit", - tha Coen.

Fluturimi i parë i X-59 është synuar për fillimin e vitit 2023.

Jim Banke,
Drejtorja e Misionit Kërkimor të Aeronautikës



X-59 i NASA-s, pjesa qendrore e misionit "Quesst" të agjencisë për të ndihmuar në mundësimin e udhëtimit komercial supersonik mbi tokë, shihet në këtë ilustrim nga "Lockheed Martin", kompania me të cilën NASA ka kontraktuar për të projektuar, ndërtuar dhe kryer testet fillestare të fluturimit me aeroplanin. Fluturimi i parë synohet për vitin 2023. Foto: Lockheed Martin

NGA KOLANA "SKËNDERBEGASIT NDËR VITE"


Ismet Varfi, boksieri i talentuar dhe ushtaraku i njohur i karrierës

Skënderbegasi, sportisti i njohur dhe ushtaraku madhor Ismet Varfi, u lind më 6 qershor të vitit 1943, në Dhëmban të Tepelenës, në një familje të njohur për traditat atdhetare e patriotike. Ismeti, në vitin 1957, filloi studimet në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" dhe i përfundoi me rezultate të mira. Pas saj, kreu studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe në vitin 1963 titullohet oficer aktiv. Për plot 10 vjet, Ismet Varfi ka shërbyer si kuadër në Shkollën Ushtarake "Skënderbej", aty ku nisi udhën e re të jetës dhe të karrierës së njohur si sportist elitare. Në vitet 1973-1975, Ismet Varfi përfundoi dhe Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu". Në vitet 1973-1980, ai ka kryer detyra të rëndësishme në shtabet e njëjësive të garnizonit të Tiranës. "...Në shkollën 'Skënderbej', u rrita, u edukova dhe mësova shumë se ç' është shoqëria, jeta kolektive-ushtarake, në këtë shkollë ushtroam dhe sportin. Kjo shkollë më edukoi dhe më pajisi me virtyte të larta kombëtare, por dhe si kuadër ushtarak, ku më vonë do të merrja përsipër detyra të rëndësishme", - pohon Ismeti.

Për aftësi të larta organizuese, profesionale dhe drejtuese, në vitin 1980, Ismeti u emërua Komandant i Brigadës së 6-të të Rinisë Shkollore në Tiranë, detyrë të cilën e kreu me sukses deri në vitin 1992, duke arritur gradën e kolonelit. Me punën e përkushtimin e tij të njohur, korrektesën e marrëdhëniet e mira që dinte të krijonte, ai gëzon respekt tek pedagogët e studentët që patën mundësinë të punonin me të. Në vitin 1992, në

kuadër të të quajturës reformë, si shumë kolegë të tjerë, Ismeti nxirret në lirim. Për situatën e krijuar në trazirat e vitit 1997, Ministria e Mbrojtjes e thirri përsëri në detyrë kolonel Ismet Varfin, duke e emëruar zëvendës drejtor të Policisë Ushtarake. Në vitin 2000, për shkak të moshës, Ismeti del në pension.

Por Ismet Varfi, ka një karrierë shumë të pasur në fushën e boksit, si sportist i ekipit të "Partizanit" e atij përfaqësues, sport të cilin e nisi në bankat e Shkollës Ushtarake "Skënderbej". Përveç titujve me ekipin e të rinjve, ai ka fituar si boksier me ekipin e të rriturve të "Partizanit" dhe titujt e kampionit në vitet 1961, 1962, 1963. Njëkohësisht, ka kontribuar dukshëm dhe si trajner e gjyqtar sportiv i boksit. Ismeti është një nga 11 themeluesit e Shoqatës së Boksit të Shqipërisë më 1991 dhe më pas të Federatës Shqiptare të Boksit. Që me krijimin e Federatës Shqiptare të Boksit, Ismeti u zgjodh Kryetar i Kolegjiumit Qendror të gjyqtarëve, ku ai ka një meritë të veçantë në përgatitjen dhe aftësimin e gjyqtarëve. Në vitin 1999 e në vazhdim, Ismeti kryen detyrën e trajnerit të boksit, duke punuar e përgatitur boksierë të rinj e të talentuar, kampionë kombëtar e fitues të trofeve e medaljeve të ndryshme. Në fushën e sportit, Ismet Varfi është nderuar me "Medaljen e argjendit", ndërsa i janë dhënë shumë urdhra e medalje shtetërore. Por kontributi i Ismetit është i veçantë dhe në përgatitjen e nxënësve skënderbegas, veçanërisht në atë ushtarake, gjatë një dekade që ai kreu detyrën në Shkollën Ushtarake "Skënderbej".



Ismet Varfi, ka një karrierë shumë të pasur në fushën e boksit, si sportist i ekipit të "Partizanit" e atij përfaqësues, sport të cilin e nisi në bankat e Shkollës Ushtarake "Skënderbej". Përveç titujve me ekipin e të rinjve, ai ka fituar si boksier me ekipin e të rriturve të "Partizanit" dhe titujt e kampionit në vitet 1961, 1962, 1963. Njëkohësisht, ka kontribuar dukshëm dhe si trajner e gjyqtar sportiv i boksit.



Neptun Bajko, futbollist i shquar i "Partizanit" dhe trajner i ekipit kombëtar të Shqipërisë

Neptun Bajko u lind në Tiranë, më 12 gusht 1958. Ai ka qenë disa herë trajner i ekipit "Partizani", ku ka luajtur shumë vite, i Kombëtares Shqiptare të futbollit dhe disa ekiyeve të tjera. Shkolla Ushtarake "Skënderbej", ashtu si për shumë sportistë elitare të Shqipërisë, ishte vatra ku u evidentua dhe u përgatit edhe Neptun Bajko, një nga sportistët e njohur të vendit, anëtar i ekipit të futbollit "Partizani", ekipit kombëtar të Shqipërisë dhe ekiyeve të tjera...

Neptun Bajko ka drejtuar si trajner ekipet: "FK Partizani", Tiranë, 16 korrik 2010 - 4 prill 2011; "Besëlidhja", Lezhë, 1 korrik 2009 - 30 qershor 2010;

"FK Partizani", Tiranë, 1 korrik 2005 - 30 shtator 2005; "FK Partizani", Tiranë, 1 korrik 1986 - 30 qershor 1988.

Ish-trajneri i njohur i Partizanit dhe i Kombëtares, Neptun Bajko, është i pari që fitoi një ndeshje në transfertë me Përfaqësuesen, atë 3-2 me Moldavinë në Kishinau (7 qershor 1995), për eliminatorët e Euro 1996... Si lojtar i Partizanit, Bajko ka fituar titullin kampion në sezon 1970 - 1971, me trajner Loro Boriçin. Për t'u mbajtur mend është goli i tij kundër Torinos, në Kupën e Kupave. Si trajner i të kuqeve e ka fituar atë në sezonin 1986 - 1987. Bajko e ka drejtuar Kombëtaren në fushatën eliminatorë të Euro 1996 (10 ndeshje) dhe në kualifikueset e Botërorit 1998 (3 ndeshje). E drejtoi Shqipërinë në 13 ndeshje zyrtare, duke pasur regjistruar 2 fitore, 3 barazime dhe 8 humbje. Ai humbi dy herë 2-1 me Gjermaninë, ndërkohë që barazoi 1-1 me Bullgarinë, në atë kohë vendi i katërt në

botë. Bajko ka zhvilluar 15 ndeshje në total me Kombëtaren, përfshirë dhe dy miqësore me Bosnjën. Ai e mori detyrën nga Bejkush Birçe dhe ia pasoi Astrit Hafizit. Bajko vlerësohet si një nga njohësit më të mirë të futbollit në Shqipëri.

"Kam pasur një brez të shkëlqyer lojtarësh. Ndoshta më të mirët e viteve 1985 - 1995. Dua të kujtoj kapitenin Sulejman Demollarin, që bëri jo vetëm emër me 'Dinamon' tonë, por dhe me 'Dinamon' e Bukureshtit. Një lojtar i jashtëzakonshëm. Një emblemë e vërtetë. Emra të tjerë të rëndësishëm ishin Bledar Kola, Artur Lekbello, Rudi Vata, Lefter Millo, Sokol Kushta, Foto Strakosha, Altin Rraklli, Arjan Xhumba, Arjan Bellai, Kliton Bozgo, Eduard Abazi, etj...", - kujton mjeshtri Neptun Bajko.

...Neptun Bajko i ka shënuar një gol Torinos së famshme, kur "Partizani" u ndesh me skuadrën italiane për Kupën e Fituesve të Kupave, në sezonin 1968 - 1969. "Partizani" fitoi 1-0 me "Torinon" në Tiranë, me golin e Pëllumb Shaqirit, ndërkohë që humbi 3-1 në Torino. Pikërisht, në ndeshjen e dytë shënoi Bajko ('85). Neptun Bajko ishte trajneri i "Partizanit", kundër Benfikës së Portugalisë për Ligën e Kampionëve (1987-1988), në një prej ndeshjeve më të përfolura. Të kuqtë humbën 4-0, por gjyqtari spanjoll Hoze Donato Pes Perez e ndëshkoi "Partizanin" me katër kartonë të kuq, përfshirë dhe portierin Perlat Musta.

**Kujtim Boriçi
Maksim Fejzullai**

Osman Elmaz Met'hasani, nëntogeri i Ushtrisë Kombëtare që dha jetën në luftë me serbët, në gusht të vitit 1921, në Arras të Dibrës

Osmani, i biri i Elmaz Met'hasanit ka lindur në Sohodoll të Dibrës në vitin 1880 dhe është rritur në një familje me tradita atdhetare. I ati i tij Elmazi ka marrë pjesë në Luftën e Shkodrës (tetor 1912- prill 1913) dhe në luftën e Kaushit 1915. Elmazi ishte një nga miqtë më besnikë dhe një nga luftëtarët më të zotë të Elez Isufit. Elmaz Mona, siç i fliste populli, sepse mbante për mbiemër, emrin e babait, të Osmanit të parë, ishte një burrë që e pyesnin për mend. Ai kishte meritën që fshati të ishte i bashkuar kundër pushtuesve si dhe në punët e përditshme, në halle e vështirësi, zi buke, tërmete, stuhi etj. Së bashku me bashkëfshatarët e tij Hamza Baftjarin, Dalip Destanin, Tahir Tafën dhe Sherif Balin ishte në krye të fshatit. Populli do të këndonte për këtë prijës: "Elmaz Mona, mustaqeziu, kudo fshatit ai i priu/I priu në luftë dhe në beteja, si shkrepitja e si rrufeja."

Në gjurmët e të atit vazhdoi edhe i biri, Osmani. Nga ky fis atdhetar kishin dhënë jetën të masakruar nga serbët, bashkëshortët Mazllëm e Bilure Met'hasani, nga ky fshat kishin dhënë jetën Tosum Halimi, Emin Habe Cibaku, Emin Shahin Cela, Abdulla Emin Cibaku, Hasan Ibrahim Sadiku, Sulejman Baftjar Cibaku, Dalip Osman Tafa, Rustem Elmaz Xhediku, Ibrahim Huta, Zeqir Rexhep Koka, Habe Zan Merdini, Maliq Rexhep Haraciu, Rexhep Maliq Haraciu, Sherif Ismail Bali, Zeqir Baftjar Merdini dhe shumë të tjerë që nga Beteja e Drinit kundër Hajredin pashës e vitit 1844. Në Sohodoll serbët dogjën dhe grabitën tre dyqane, 60 shtëpi dhe i masakruan burra, gra, pleq e fëmijë. Vodhën edhe 200 dele e 30 kuaj.

Osmani mori pjesë në të gjitha luftërat kundër serbëve së bashku me disa kushërinj dhe bashkëfshatarë të tij, si në luftën e gushtit 1920, ashtu edhe të gushtit 1921, nga Arrasi deri në Lan Lurë. Ai ishte pjesë e ushtrisë kombëtare me gradën nëntoger.

Në gusht të vitit 1920, serbët hynë në fshatin e tij, në Sohodoll dhe arrestojnë e grumbullojnë në një shtëpi për t'i vlarë shumë bashkëfshatarë të Osmanit, i cili sapo ishte kthyer nga Durrësi, ku kishte shkuar për të furnizuar



dyqanin e fshatit që e mbante në shtëpinë e tij. Ndërhyn me pistoletën e brezit që e mbante me leje, vret rojën dhe shpëton burrat dhe gratë e fshatit që do të pushkatoheshin të nesërmen në mëngjes.

Prof. Bajram Xhafa, duke iu referuar kujtimeve të Elez Isufit në librin e tij "Lufta e Dibrës e vitit 1920", faqe 232 dhe 357 shkruan se në gusht të vitit 1921, në Mirditë plasi kryengritja e Gjon Marka Gjonit, i cili kërkonte shkëputje nga Shqipëria dhe vendosje nën Serbi, të "Republikës së Mirditës". Serbia i vjen menjëherë në ndihmë Markagjonit me një fuqi të vetën të ndihmuar nga qindra mercenarë."

U dha kushtrimi dhe forcat e Elez Isufit, të Recit, Dardhës, Cidhnës e Lurës dalin dhe i bëjnë pritë forcave serbe e mercenarëve për të mos arritur në Mirditë.

Në Arras u bë një përpjekje e madhe ku bënte pjesë si oficer dhe komandant edhe nëntogeri i Ushtrisë Kombëtare Osman Elmaz Met'hasani. Në Cukë të Arrasit e Kodër Leshe, luftëtarëve u printe Osman Methasani dhe në përpjekje për të eliminuar një istikam, ku qëllonte pa ndërprerë një mitroloz armik, ra vetë Osmani.

Dëshmitari okular, anëtari i shtabit të kryengritjes së Dibrës, Ismail Strazimiri shkruan: "Gusht 1921. Fuqija mercenare e serbëve n'Arras mundi me qendru e me zanë vend. Kapitani kreshnik Prenk Jaku e vendosi fuqin e këtyne malsorëve trima e të provue në rasi të tilla në Grykë Nokë e në Kodër Leshe, tue i vu nën komandë të nëntoger Luigj Shantojes, të cilit i la nja tridhjetë ushtarë e dy mitralierë nga të vetët. Mbasandej u nis dhe shkoi te ura e Vezirit.

Nja nji jave nuk ngjau kurgja. Gjendja vazhdoi të jete e qetë.

Toger Shefki Shatku erdhi nga Tirana dhe mori komandën e fuqisë prej nëntoger Luigj Shantojes dhe e shpërndau municionin ndër ushtarët e vullnetarët që përbajshin fuqinë. Mbasandaj, muer dhe e nxiti për me i sulmue mercenarët q'ishin ngujue në Arras. Me nji fuqi të përbame prej 200 dernjane dhe nja 300 nga Gryka e Nokës i mësyen kundërshtarët, të cilët u thyen aq keq sa u vunë në t'ikun, të tmerue dhe e kapërcyen Drinin të veshun me petka, nji numër i konsiderueshem nga komiteti u vranë, nga kjo anë mbeti deshmor vetëm nëntoger Osman Elmaz Methasani nga katundi Sohodoll."

Toger Shefkiu mbasi e kurorëzoi këtë betejë me fitore, vendosi nji fuqi në Arras nën komandën e oficerit Qemal Frashërit dhe vetë u kthye në Tiranë,


“
NË GUSHT TË
VITIT 1921, NË
MIRDITË PLASI
KRYENGRITJA E
GJON MARKA
GJONIT, I CILI
KËRKONTE
SHKËPUTJE NGA
SHQIPËRIA DHE
VENDOSJE NËN
SERBI, TË
“REPUBLIKËS SË
MIRDITËS”. SERBIA
I VJEN MENJËHERË
NË NDIHMË MARKA-
GJONIT ME NJË FUQI
TË VETËN TË
NDIHMUAR NGA
QINDRA MERCENARË.

pasi serbët u shporrën në anën tjetër të Drinit, i cili u ba vetvetiu kufi.

Populli e përjetësoi në këngë: "Ti biem burra ktij dushmani / Po vikat Man Methasani / Në kodër të Arrasit fyt a fyt / Me dushmanin gryk' për grykë / Kush asht ai që po prin / mitrolozin e përpin / Porsi Mic Sokoli edhe Osmani / se i thonë Man Met'hasani. (Sh. Methasani, Sohodolli i Dibrës, faqe 20 - 22, viti 2004).

Me Vendimin Nr. 72 të Këshillit Popullor Dibrë, datë 23.05.1978, Osman Met'hasani është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Në gjurmët e tij ecin sot nipërit e mbesat, ish-ushtarakët madhorë Agim dhe Avni Met'hasani dhe të gjithë.

Nga Sakip Cami



Në kuadër të ristrukturimit dhe funksionimit të Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura, si dhe impaktit të saj në jetën social-kulturore të FA-së, duke ju referuar prioritetit shtetëror, i cili ka të bëjë me festimet e 110 vjetorit të krijimit të shtetit Shqiptar, dhe përvjetorin e themelimit të Ushtrisë Shqiptare, kërkohet bashkëpunimi i strukturave të Forcave të Armatosura, me qëllim evidentimin, përzgjedhjen dhe rekrutimin e ushtarakëve të aftë, e me dhunti për të marrë pjesë në korin e FA-së që po ngrihet. Ky formacion artistik do të jetë një nga shtyllat kryesore të festimeve të 110 vjetorit të krijimit të shtetit Shqiptar, krahas Orkestrës Simfonike e sapo krijuar, si dhe Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura.

NJOFTIM!

Në kuadër të **ristrukturimit** dhe funksionimit të **Qendrës së Kulturës,**

Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të

Forcave të Armatosura, si dhe impaktit të saj në

jetën social-kulturore të FA-së, duke iu referuar

prioritetit shtetëror, i cili ka të bëjë me festimet e

110-vjetorit të krijimit të

shtetit **Shqiptar**, dhe përvjetorin e theme-

limit të **Ushtrisë** Shqiptare, kërkohet

bashkëpunimi i strukturave të **Forcave**

të Armatosura, me qëllim evidenti-

min, përzgjedhjen dhe rekrutimin e ushtarakëve të

aftë e me dhunti për të marrë pjesë në korin e

FA-së që po ngrihet.

Ky formacion artistik do të jetë një nga shtyllat

kryesore të festimeve të 110-vjetorit të krijimit të

shtetit Shqiptar, krahas **Orkestrës**

Simfonike të sapo krijuar, si dhe Orkestrës

Frymore të Forcave të Armatosura.